



VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.8(398)

GUSHT 2021 ÇMIMI: 30 LEKË



Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI Email: veterani.obvl@yahoo.com / website: www.VETERANIOBVL.ORG

PERSONALITETE



GJENERAL NEXHIP VINÇANI, KOMANDANT DHE INTELEKTUAL I TALENTUAR

FAQE 5

HISTORIA



Kolonel Sotir Budina

77 VJET MË PARË, KONGRESI HISTORIK I BRASH-IT

FAQE 3

DITËLINDJA



PROF. XHEMAL MEÇI FESTON 85-VJETORIN E LINDJES

FAQE 12

Eksperti amerikan/ Serwer: SHBA, BE dhe NATO të reagojnë ndaj idesë së “botës serbe”! Ja cili është qëllimi i Vuçiç-it

NATO do të mbrojë të gjithë fqinjët e Serbisë nga qëllimet e Beogradit

LIBRI I DR.FEMI SUFAJ: BURGJET SHQIPTARE 1912-1990

Halil RAMA

Libri “Sistemi i ndëshkimeve në Shqipëri gjatë regjimit komunist” (1945-1990) i dr.Fehmi Sufaj është një vlerë e shtuar në fondin e letërsisë sonë dokumentare. Burimet e shumta dokumentare dhe bibliografia e pasur flasin për një vepër studimore-shkencore të llojit dhe rëndësisë së veçantë. Kjo parasëgjithash konsiston në shfrytëzimin e më shumë se njëqint dokumentave arkivore të pabotuara të Arkivit Qëndror të Shtetit sidhe 167 dosjeve të kampeve e burgjeve 1945-1974, nga të cilat autori ka nxjerrë esencën e evolucionit gati shekullor të sistemit të burgjeve në vendin tonë.

Dhe ndonëse në titullin e librit ai duket se flet për një periudhë kohore 45-vjeçare, jo pak por 46 faqet e para të librit janë një vështrim i vëmendshëm historik mbi dënimet 1912-1944.


Që në parathënie Dr.Femi Sufaj shprehet se portat e burgjeve janë një rrugë e brendshme, ku mund të kalohet për të kuptuar më mirë historinë e shoqërisë në përgjithësi. Parë nga ky këndvështrim ai argumenton më së miri se “Shkalla e demokratizimit të një shoqërie, hapësirat e lirisë që ekzistojnë dhe respektimi i të drejtave njerëzore, do të kuptohen më mirë duke parë se si shteti i trajton personat e dënuar me heqje të lirisë dhe si e bën drejtësinë”. Për këtë ai sjell referenca bindëse nga literatura historiografike, jo vetëm ajo shqiptare por edhe e personaliteve botërore.

(Vijon në faqen 6)



- **“Aleksandër Vulin është bërë zëdhënësi kryesor i idesë ‘bota serbe’ që i atribuohet presidentit Aleksandër Vuçiç. Kjo ide është një version i nxehtë i ‘Serbisë së madhe’ të Sllobodan Millosheviçit, që dështoi të realizohej, pasi humbi katër luftëra në vitet 1990-ta”, ka thënë Serwer.**

LIBRI



FATMIR MINGULI

Një vepër letrare që ju bën nder atyre që vuajtën mizoritë komuniste

“Klithma nga burgu” i Shpendi Topollajt, homazhi më njerëzor

FAQE 11

KUJTME

PESË MUAJ LUFTIME TË PËRGJAKËSHME TË BRIGADËS së 18 SULMUESE

FAQE 4

PROFILI

MUHARREM ÇOTA (HOXHË ÇOTA), FIGURË E SHQUAR E TREVËS SË LIBRAZHBIT

Lavdim Çota & Zabit Çuku

Studiues

FAQE 3

TAHIR KOÇI ÇAKËRI, ISH PARTIZANI ME “NJOLLË” NË BIOGRAFI

FAQE 9

HOMAZH

PROF. HIQMET GONXHJA, VETERANI I INXHINIERISË SHQIPTARE

FAQE 10

REAGIMI

Eksperti amerikan/ Serwer: SHBA, BE dhe NATO të reagojnë ndaj idesë së “botës serbe”! Ja cili është qëllimi i Vuçiç-it

• “Aleksandër Vulin është bërë zëdhënës kryesor i idesë ‘bota serbe’ që i atribuohet presidentit Aleksandër Vuçiç. Kjo ide është një version i nxehhtë i ‘Serbisë së madhe’ të Slobodan Millosheviçit, që dështoi të realizohej, pasi humbi katër luftëra në vitet 1990-ta”, ka thënë Serwer.

NATO do të mbrojë të gjithë fqinjët e Serbisë nga qëllimet e Beogradit



SHBA-ja, Bashkimi Evropian dhe NATO duhet ta njohin ideologjinë e “botës serbe” si anti-demokratike dhe ta kundërshtojnë kategorikisht atë, ka thënë profesori i Universitetit John Hopkins, Daniel Serwer, në një intervistë për gazetën boshnjake “Dnevni Avaz”.

“Aleksandar Vulin është bërë zëdhënës kryesor i idesë ‘bota serbe’ që i atribuohet presidentit Aleksandar Vuçiç. Kjo ide është një version i nxehhtë i ‘Serbisë së madhe’ të Slobodan Millosheviçit, që dështoi të realizohej, pasi humbi katër luftëra në vitet 1990-ta”, ka thënë Serwer.

Serwer thotë se Vuçiçi dëshiron që serbët të bashkohen në një hapësirë të vetme politike dhe shtet të vetëm, pa dhunë. “Mundësitë për këtë janë të vogla, dhe Serbia ka tetë fqinj. Gjitha shtetet fqinje kanë minoritete serbe, ndonëse në Bullgari numri është shumë i vogël. Gjashhtë nga këto shtete janë anëtare të NATO-s (Kroacia, Bull-

garia, Hungaria, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Rumania). Dy të tjerat janë nikoqire të trupave të BE-së dhe NATO-s, që janë të përkushtuar për mbrojtjen e integritetit territorial të tyre, e këto janë Bosnjë-Hercegovina e Kosova. Çfarë ndodhi kur Serbia në vitet e 90-ta tentoi të zgjeronte territorin e saj politik dhe të bashkojë disa prej atyre pakicave në një shtet? Luftë në Slloveni, Kroaci, Bosnjë-Hercegovinë, Kosovë dhe me NATO-n. Rezultati është që serbët nga ato shtete ikën në Serbi dhe asnjë pëllëmbë e vendeve fqinje nuk iu dha Serbisë”, deklaroi

Serwer.

Serwer ka thënë se në një formë klasike të një agresori, Vulin ka shpjeguar këtë nevojë me dëmin e shkakuar ndaj serbëve.

“Vetëviktimizimi është një pararendës klasik i dhunës. Memorandumi SANU, që Millosheviq e përdori për të justifikuar luftërat e tij, u përqendrua në pretendimet se serbët ishin viktimë në Jugosllavi. Në lajmet tjera, anëtarët e presidencës së Bosnjë-Hercegovinës, Milorad Dodik, po e para-lajmëron ambasadorin amerikan në Bosnjë-Hercegovinë që nuk do të pranojë

vendimin për të emëruar një Përfaqësues të Lartë të ri. Dodik pretendon se ai do ta mbrojë vet Daytonin, apo më mirë të themi atë që ai mendon për Daytonin”, tha Serwer.

Profesori amerikan thotë se është fakt që “bota serbe” është rrezik dhe kërcënim ndaj paqes dhe stabilitetit në rajon.

“Deklarimet e Vuçiçit se nuk do të shtihet asnjë plumb janë të zbrazëta. Nëse ai vërtetë do të besonte në këtë, nuk do të armatoste Serbinë me armë ruse e kineze. Ai mendon, se nëse Serbia bëhet mjaf-tueshëm e fortë, fqinjët e saj do të heqin dorë nga territori, e nuk do të rrezikojnë luftë. Nuk ka asnjë arsye për të menduar se kjo do të ndodhë apo se Serbia nuk do të përdorë armë nëse e mendon, si Millosheviçi, se mund të fitojë”, thotë Serwer.

Serwer beson se Vuçiçi është i gatshëm të heq dorë nga okupimi i plotë i Kosovës dhe Bosnjë-Hercegovinës.

“E gjitha që do ai është ‘pjesë serbe’, rreth 15 për qind të Kosovës dhe 49 për qind të Bosnjë-Hercegovinës. Ai do të ishte i lumtur me një ‘copë’ të Kroacisë, e ndoshta kjo është Sllovenia Lindore. Dëshiron të Malin e Zi. Është koha e fundit që Brukseli t’i thotë se BE-ja më nuk do të pre-tendojë se anëtarësimi është një mundësi për një vend që kultivon ambicie territoriale dhe nuk re-spekton kufijtë e fqinjëve të saj. Është koha që edhe Washingtoni të jep sinjale të qartë se NATO do të mbrojë të gjithë fqinjët e Serbisë nga qëllimet e Beogradit”, tha Serwer.

/Koha.net/

“Diskutimet që mund të prodhojnë vetëm konflikt të ngrirë”

Analiza e DW: Ç’sollën dy takimet Kurti-Vuçiç?!

Dy takimet Kurti-Vuçiç në kuadër të dialogut Kosovë-Serbi që kaluan vetëm me akuza dhe kundërrakuza, sipas analistëve mund të prodhojnë vetëm konflikt të ngrirë. Marrëveshja përfundimtare nuk duket në sfond.

Partitë politike opozitare e kritikuan kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, për takimin e fundit në Bruksel me presidentin e Serbisë Aleksandër Vuçiç, dhe qasjen e tij ndaj dialogut me Serbinë, duke i cilësuar takimet si thonë “takime që nuk po prodhojnë asnjë rezultat”. Kurti dhe Vuçiç në takimin e fundit që u mbajt në Bruksel më 19 korrik, nuk u pajtuan për asgjë, ndërsa, me një dozë nervozizmi akuzuan njëri-tjetrin duke refuzuar propozimet e ndërsjella që ofruan në takim.

PERFORMANCË PËR KONSUM TË BRENDSHËM

Zëdhënësja e partisë opozitare Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), Sibel Halimi, thotë se “mungesa e platformës së dialogut me Serbinë, me objektiva të qarta të prezantuar në Kuvend para dhe pas çdo takimi, do ta reduktojë Kosovën në nivelin e performancës për konsum të brendshëm të kryeministrin Albin Kurti”. “Procesi i dialogut do të duhet të orientohet në përcaktimin e saktë të vi-zionit se çfarë në të vërtetë Kosova mëton të arrijë nga ky proces dialogu. Deri tani, ajo çfarë kemi parë nga takimet, nuk janë asgjë tjetër pos një mundësi e jashtëzakonshme e Kurtit drejtuar audiencës së tij për të akumuluar fuqi politike. Turma karakterizohet për irracionitet, i lëvizur me situatat e përafërta me të ngjashmin e vet, andaj qasja e kryeministrin është pa vizion!”, shkroi Sibel Halimi në Facebook.

MUNGESË TRANSPARENCE RRETH BISEDIMEVE

Edhe shefi i grupit parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në opozitë Abelard Tahiri, tha se “procesi i dialogut me Serbinë po përcillet me jo transparencë, ngase qytetarët nuk e dinë se për çfarë temash po diskutohet”. “Këtë dialog Kurti po e përcjell me mostransparencë, pra qytetarët nuk dinë asgjë se çka bisedon Kurti me Vuçiçin. Rreziku ekziston që për herë të parë Kosova të kthehet pala e pa arsyeshme”, tha Abelard Tahiri.

Haradinaj: Takim i kotë i dialogut Kosovë-Serbi Ish-kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, që udhëheq partinë tjetër opozitare Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) takimin e fundit Kurti-Vuçiç e cilësoi “një takim kot i dialogut Kosovë-Serbi”. Ai tha se “secila palë ka veç një interes, që me retorika populiste ta mashtrorë popullin e vet në prag të zgjedhjeve”. “Kryeministri i Kosovës ka vendosur që të mos bëjë asgjë në këtë proces. Ai nuk po don me e kuptu se pa përfshirjen e SHBA, dialogu është i vdekur. Ai nuk po don me e kuptu se me Borrelin e Lajçakun është në qorrso-kak. Sa më larg të shtyhet përfshirja e një emisari amerikan në dialog, dëmi do të jetë më i madh, edhe për Kosovën edhe për Kryeministrin! Po të ishte Amerika në dialog, tashmë do të ishim në prag të marrëveshjes përfundimtare! A ka njeri që mund t’ia shpjegojë këtë Albin Kurtit!”, shkroi Haradinaj në facebook.



BISEDIMET MË SHUMË LIGJËRATA HISTORIKE SESA PROPOZIME KONKRETE

Ndërkohë disa analistë politikë mendojnë se duke e parë qasjen e deritashme të palëve nga dy takimet ndërmjet kryeministrin të Kosovës, Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë Aleksandër Vuçiç, marrëveshja përfundimtare Kosovë-Serbi duket e pamundur. Blerim Burjani analist politik i tha DW-së se takimet në Bruksel po ngjasojnë më shumë me ligjëratat historike sesa me propozime konkrete. “Ndërmjetësimi është pozitiv por, sikur t’i shtohet edhe ndikimi më i madh i SHBA-së, ndoshta do të jetë më i lehtë dialogu. Marrëveshja përfundimtare është shumë larg. Në vend të propozimeve që duhet të bëjnë palët dhe të bien dakord me ndonjë opsion të mundshëm për zgjidhje, realisht ata në këto takime në Bruksel po bëjnë debate që më shumë po ngjasojnë në ligjëratat për historinë. Nëse vazhdojnë të bëhen debate për marrëdhëniet ndëretnike Kosovë-Serbi, marrëveshje nuk do të ketë, por, stagnim dhe një status-quo”, thotë Burjani. Sipas tij, pa një propozim konkret qoftë nga ndërmjetësuesi i dialogut, debatet Kosovë-Serbi do të vazhdojnë dhe që do të prodhojnë një konflikt të ngrirë dhe jo vullnet për zgjidhje.

(Vijon në faqen 3)

HISTORIA

8 gushti i vitit 1944 Ngjarje e shënuar në historinë e Shqipërisë

77 vjet më parë – Kongresi historik i BRASH-it

Në këtë kongres morën pjesë 285 delegatë (nga të cilët 75 ishin të reja) që përfaqësonin rininë dhe pionierët e të gjitha krahinave dhe qyteteve të Shqipërisë dhe të Ushtrisë Nacionalçlirimtare

Nga Sotir BUDINA
Kryetar i OBVL

Shtatëdhjeteshtatë vjet më parë, më 8 gusht të vitit 1944, zhvilloi punimet Kongresi i Parë historik i Rinisë Antifashiste Shqiptare. Kongresi u mbledh për të analizuar punën e luftës e rinisë në të gjitha krahinat e vendit dhe për të përcaktuar detyrat e saj në mësymjen përfundimtare kundër pushtuesve e tradhëtarëve dhe për rindërtimin e Shqipërisë së re.

Do të kalojnë shumë vite dhe kjo datë do të kujtohet gjithmonë si një ngjarje e shënuar në historinë e Shqipërisë, pasi për herë të parë rinia shqiptare në këtë kongres, si asnjëherë tjetër u bashkua dhe u hodh totalisht në luftë kundër okupatorit nazifashist dhe tregoi aftësitë dhe forcën e saj. Ajo nga zjarri i saj rinor i dha zjarr Luftës Nacionalçlirimtare an e kand Shqipërisë, duke mbushur me të rinj njësitet guerrile të qyteteve dhe fshatrave, batalionet, brigadat e divizionet partizane që luftuan me heroizëm e vetmohim deri në çlirimin e plotë të atdheut.

Pikërisht për këtë arsye, pushtuesit në të gjitha krahinat e vendit u munduan ta pengonin atë duke internuar, burgosur, torturuar e pushkatuar me dhjetra të rinj antifashistë. Shumë prej tyre u varën dhe në litar, por ata nuk u përkulën. Me qindra janë heronjtë dhe dëshmorët që rinia jonë heroike i dha

kësaj lufte të drejtë në të gjitha krahinat e vendit. Të paharruar do të ngelen heronjtë e parë të rinisë antifashiste shqiptare, si Midhi Kostani e Kiço Greço në qytetin e Korçës që u varën në litar, Qemal Stafa e Misto Mame në Tiranë, Heronjtë e Vigut në Shkodër, Persefoni Kokëdhima në Gjirokastrë, Margarita e Kristaq Tutulani në Berat, etj; heronj këta që u bënë shembull heroizmi dhe bashkimi në luftë kundër okupatorit nazifashist. Populli shqiptar përulet me respekt përpara gjakut dhe saktificave të këtyre heronjve.

Në verën e vitit 1944, kur lufta kundër pushtuesit kishte marrë përmasa të mëdha në të gjithë vendin dhe kur trupat sovjetike po i afroreshin Ballkanit Perëndimor, Organizata e Rinisë Antifashiste Shqiptare, e drejtuar me guxim e mençuri nga Sekretari i saj i Parë, Nako Spiru, thirri Kongresin e saj të parë në Helmës të Skraparit. Në këtë vend malor që edhe në të kaluarën ka qenë vatër e çetave të Rilindjes sonë Kombëtare, më 8 gusht 1944, në frymën e një entuziazmi të papërshkruar u hap Kongresi i I-rë i Rinisë Antifashiste Shqiptare.

Në këtë kongres morën pjesë 285 delegatë (nga të cilët 75 ishin të reja) që përfaqësonin rininë dhe pionierët e të gjitha krahinave dhe qyteteve të Shqipërisë dhe të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Me një dashuri dhe entuziazëm të paparë u pritën delegatët e Divizionit të I-rë S, të Brigadave të I-rë, IV-t dhe të



V-të Sulmuese, gjithsesj 27 veta që vinin nga vija e parë e luftës për çlirimin e Shqipërisë së Veriut, duke marshuar më këmbë me qindra kilometra nga Mirdita dhe Dibra deri në Helmës të Skraparit, për të marrë pjesë në këtë kongres historik të Rinisë Antifashiste Shqiptare ku do të bëhej bilnaci i luftimeve dhe do të caktoheshin detyrat deri në çlirimin e plotë të atdheut.

Zëri i delegatëve të Divizionit të I-rë, të zgjedhur nga partizanët më të mirë, të dalluar në luftën kundër pushtuesve, në takimet dhe bisedat e zjarrta që bëheshin gjatë ditëve të zhvillimit të Kongresit, dëgjohej me vëmendje të veçantë. Me diskutimet e tyre, Fatmir Gjata, Dhori Panariti, Katina Starjo etj dhanë një kontribut të vyer për përcaktimin e detyrave imediate që i dëlnin Rinisë Antifashiste Shqiptare, për edukimin e saj dhe për çlirimin e rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta.

Për 10 ditë rresht Kongresi i BRASH-it diskutoi dhe analizoi punën që ishte bërë për bashkimin e Rinisë Antifashiste Shqiptare dhe sukseset e arritura

prej saj në luftën kundër okupatorit nazifashist, si dhe u përcaktuan detyrat të rëndësishme për një pjesëmarrje më të madhe të rinisë në repartet partizane dhe për aktivizimin e mëtejshëm në luftën Nacionalçlirimtare. Pikërisht për këtë, fitorja e 28 Nëntorit 1944 që shënoi çlirimin e plotë të Shqipërisë ishte dhe fitore e madhe e Rinisë Antifashiste Shqiptare që përbënte 70 përqind të efektivit të forcave partizane dhe që i dha atdheut me qindra dëshmorë në të gjitha krahinat e vendit.

Kongresi i Parë i BRASH-it, për detyrat shumë të rëndësishme që përcakttoi, për një pjesëmarrje më të madhe të rinisë në luftën Nacionalçlirimtare për çlirimin e plotë të vendit, për miqësinë dhe dashurinë e sinqertë që ngjalli ndërmjet delegatëve, për punën edukative që u bë me delegatët gjatë ditëve të Kongresit, si dhe për detyrat shumë të rëndësishme që përcakttoi për rindërtimin e vendit të shkatërruar nga lufta, etj, ka mbetur dhe do të mbetet i paharruar në kujtesën e gjithë delegatëve, të cilët edhe pse kanë kaluar 77 vjet nga ajo kohë, i kujtojnë me mall ato ditë ta lavdishme.

Duke kujtuar ato ditë të lavdishme të Luftës Nacionalçlirimtare, kur ideali i madh i lirisë na çoi në vijën e parë të frontit në ndeshjen drejtpërdrejt me pushtuesin e egër, pa iu trembur plumbave që merrnim në krahator, duke dhënë dhe jetën për një atdhe të lirë e demokratik, i bëjmë thirrje rinisë së sotme që të luftojë më shumë për një jetë më të mirë dhe për Shqipërinë Europiane.

Megjithë kontributin e madh që dha rinia shqiptare në luftën kundër okupatorit, ideat e saj për një Shqipëri të lirë dhe demokratike, për një jetë më të lumtur, megjithëse kanë kaluar 77 vjet nga përfundimi me fitore i asaj lufte legjendare, asnjëherë nuk u realizuan. Ideat e saj u tradhtuan nga drejtuesit e sistemit diktatorial, por edhe sot rinia endet nëpër botë për të gjetur një vend pune.

Në këtë përvjetor të 77-të të Kongresit të I-rë të BRASH-it, kur Shqipëria është tashmë anëtare e NATO-s dhe ka prët çeljen e negociatave me Bashkimin Europian, shprehim bindjen se rinia dhe populli shqiptar do të realizojnë aspiratën e tyre të integritimit të plotë euroatlantik.

**Autori ka qenë Delegat i Divizionit të I-rë në Kongresin e I-rë të BRASH-it*

DW

Analiza e DW: Ç'sollën dy takimet Kurti-Vuçiq?!

(Vijon nga faqja 2)

DEBATET KOSOVË-SERBI PRODHOJNË NJË KONFLIKT TË NGRIRË

“Mendoj që pa pasur një dokument të hartuar nga SHBA dhe BE që do t’u jepet palëve për diskutim, duket se është vetëm humbje kohe. BE duhet të mendoj një opion së bashku me SHBA-të për zgjidhje përfundimtare, ndryshe nuk ka shprese aspak se palët ndonjëherë do të merren vesh për ndonjë marrëveshje përfundimtare. BE si ndërmjetësuese duket shumë latente, ofron vetëm shërbime të mira për palët, dhe ndonjëherë e kam përshtypjen se vetëm organizon takime për palët dhe nuk in-volvohet në zgjidhje. Pra mendoj se kërkohet një involvim më i madh i ndërmjetësuesit duke përf-shirë edhe SHBA-të në këtë proces”, mendon Blerim Burjani.

AKUZA DHE KUNDËR AKUZA

Dy takimet që ndodhën ndërmjet kryeministrit të Kosovës Albin Kurti dhe presidentit të Serbisë Aleksandër Vuçiq, njëri me 15 qershor dhe tjetri me 19 korrik, prodhuan akuza dhe kundërakuzat ndërmjet palëve. Pas takimit të fundit, Albin Kurti, tha se ka propozuar një

marrëveshje me 6 pika, por që ajo është refuzuar nga pala serbe ende pa u lexuar. “Unë propozova një marrëveshje të shkruar me 6 nene si një deklaratë e paqes mes Kosovës dhe Serbisë, që u refuzua, pra atë çfarë kisha kërkuar herën e kaluar që të kemi një deklaratë të paqes e kam përgatitur në mënyrë në një tekst me gjashtë nene, mirëpo u refuzua ende pa u lexuar”, tha mes tjerash Kurti. Sipas tij, refuzimi pa lexim për të tregon mungesë gatishmërie nga ana e Serbisë për marrëveshje. Ndërkohë, presidenti i Serbisë Aleksandër Vuçiq, tha se “me kryeministrin kosovar Albin Kurti, është shumë vështirë të bisedohet”.

“Kam folur edhe me Hashim Thaçin, Isa Mustafën, Avdullah Hotin e Ramush Haradinajn, por këto asnjëherë nuk i kam dëgjuar. Gjithmonë kanë kërkuar njohjen nga Serbia, gjithmonë ka qenë vështirë, por të paktën për diçka jemi marrë vesh, si për atë se është ditë, është e hënë, e premte. Por tash me Kurtin nuk mund të merremi vesh as a është ditë e as cila ditë e javës është”, ka thënë Vuçiq, transmeton mediumi publik serb rts. Sipas tij, me Kurtin nuk mund të merresh vesh për asgjë. Mediet në Serbi shkruan se pala serbe është duke diskutuar mundësinë e ndërprerjes së dialogut me Kosovën, por kjo nuk është konfirmuar nga ndërmjetësuesi i këtij dialogu Bashkimi Evropian. Takimi i radhës Koosvë-Serbi i nivelit të lartë politik, thuhet se do të mbahet në fillim të shtatorit.

KUJTIME

77 vjetori i Brigadës së 18-t Sulmuese - Nga kujtimet e veteranit Uke A. Cami*

PESË MUAJ LUFTIME TË PËRGJAKËSHME TË BRIGADËS SË 18 SULMUESE

KRONOLOGJI

U formua në Slatinë të Dibrës më 18 gusht 1944 sipas urdhërit të Shtabit të Përgjithshëm mbi bazën e tre batalioneve, të Dibrës, Martaneshit sipas urdhërit të Shtabit të Përgjithshëm mbi bazën e tre batalioneve, të Dibrës, Martaneshit, Cermetikës si dhe të partizanëve të ardhur nga krahina të tjera të vendit.

Në drejtimin e Brigadës në ditën e formimit ishin Esat Ndreu, komandant, vëllai i patriotit dhe luftëtarit Elez Isuf Ndreu, Zëvendës komandant Zoi Themeli, Mico Kallamata komisar dhe Sotir Vullkani zëvendës komisar. Më vonë u bënë ndryshime në komandën e Brigadës. Petrit Dume u bë komandant brigade, Hilmi Causholli, komisar, Xhevdet Petrela, Zëvendës komandant, Teme Sejko, Zëvendës komisar, Milo Qirko Zëvendës komisar. Gafur Korça ishte komandant i batalionit të parë, Qazim Peshku, komandant i batalionit të dytë, Ajet Rusi, komandant i batalionit të tretë dhe Gafur Mehmeti komandant i batalionit të katërt.

LUFTIMET KRYESORE

- Luftimet e kryera së bashku me Brigadën e V Sulmuese në malin e Korabit kundër forcave gjermane që bënë të dështonte faza e fundit e operacionit gjahu i dhelprave;
- Kryerja e disa aksioneve luftarake kundër automobilitëve gjermanë gjatë tërheqjes në rrugën automobilistike Prizren/Kukës/ Pukë dhe lufta për çlirimin e Kukësit;
- Luftimet përtej kufirit shtetëror për çlirimin e qytetit të Dibrës së Madhe, për çlirimin e Kërçovës dhe të Prizrenit.


HISTORIA

Me 18 gusht 1944 formohet Brigada e 18 Sulmuese me katër batalione, batalionin e Dibrës, batalionin e Martaneshit, batalionin e Çermenikës dhe batalionin e Ri që u formua ato ditë.

Gafur Korça u bë komandant i batalionit të parë, Rexhep Doda, komisar i këtij batalioni, Ferit Muha nga Bllaca u bë komandant i kompanisë parë në këtë batalion, Uke Cami komisar i kompanisë së parë.

Fill pas formimit Brigada u angazhua në luftime çlirimtare. Me 25 gusht na u dha për detyrë çlirimi i Dibrës së Madhe.

Batalioni i parë u vendos në frontin Bajnisht-Kojnarë, batalioni i katërt u vendos në frontin Bofmollë-Ura e Spiles. Frontet e tjera ishin zënë nga një pjesë e forcave të Divizionit të parë.



Pas 24 orë luftimesh forcat gjermane në qytet të ndihmuara edhe nga batalioni "Drini" i komanduar nga Dilaver Dine, u tërhoqën nga Dibra e Madhe. Dibra u çlirua.

Brigada e katërt shqiptaro-maqedonase e drejtuar nga Qemal e Nexhat Agolli dhe ku bënte pjesë edhe kushëriri im Esat Cami, mori drejtimin e Strugës dhe më pas të Shkupit.

Brigada e 18 mori urdhërin për të shkuar në drejtim të Kukësit e të Prizrenit, në mbështetje të Brigadës 5 Sulmuese ku Hajdar Dushi kishte hasur rezistencë nga forcat e Muharrem Bajraktarit në Kalanë e Dodës.

Batalioni i parë i komanduar nga Gafur Korça dhe Rexhep Doda nga mesi i natës filloi marshimin në drejtim të Kalasë së Dodës dhe në orën pesë të mëngjesit sulmon Kalanë, nga Kalla, Vlesha e Silova dhe nga Zall-Kalisi dhe pas pesë orë luftimesh të përgjakshme u mbar Kalaja. Një pjesë e mirë e luftëtarëve nacionalistë u kthyen me ne dhe luftuan deri në fund kundër gjermanëve.

Këtu kemi parë edhe masakrën më të madhe njerëzore, Hajdar Dushin me 22 shokë të vranë, ndërmyet tyre edhe 2 shoqe partizane, të cilat i kishin xhveshur lakuriq dhe u kishin ngulur nga një hu në prapnicë dhe i kishin mbështetur për shkëmbi. Urrejtja ndaj pushtuesit por edhe ndaj atyre që u shkonin pas si nacionalistë e antikomunistë nuk kishte kufi dhe nuk mund të tregohet. Përsëri njoftohemi se shtabi i brigadës së pestë është në rrezik në fshatin Ujmishtë nga forcat Muharrem Bajraktarit.

Pas rrethimit që i bëme forcave të Bajraktarit e çliruam shtabin e Brigadës së pestë, por nga kjo brigadë kishin mbetur në luftim 60 partizanë, kryesisht të vranë nga forcat e Muharrem Bajraktarit. Ja ku kishte arritur vëllavrasja midis shqiptarëve, antifashistëve dhe antikomunistëve.

Populli i kësaj zone më shumë mbështeti Nacional- Çlirimtarin se sa

Muharrem Bajraktarin dhe u rreshtua në Brigadën e 24 kundër gjermanëve.

Në këto momente tablo e luftimeve ishte e tillë: Shtabi i Br18 ishte vendosur në Bicaç, shtabi i Br 5 në Has, ndërsa forcat gjermane dhe mbështetësit e tyre në Kukës e Prizren.

Batalioni parë i Br 18 së bashku me batalionin e Lumës banë një aksion tek kulla e Lumës dhe asgjësuan një repart gjerman që vinte nga Prizreni, ku u kap rob edhe qarkkomandanti i Kukësit.

Batalionit Parë të Br 18 ju dha detyrë të sulmonte Topojanin, Zapodin dhe Dragashin. Në Dragash na u dha urdhëri për të marshuar drejt Kukësit, ku në fshatin Bardhoc bllokua rrugën automobilistike.

Kishim këputur në mes edhe urën dhe qëndronim në pritje për ardhjen e autokollonës gjermane. Pranë meje ishin Shaqir Shira nga Zall Dardha dhe Jonuz Duka nga Maqellara.

I pari hapi zjarr partizani Dine Rama nga Shumbati. Gjermanët pa urë kalimi ishin të detyruar të zbrisnin nga makinat dhe të zinin front në tokë por koha punonte për ne sepse ne ishim të pozicionuar dhe të gatshëm për të qëlluar. Në një darë të hekurt pas katër orë luftimesh, gjermanëve u vjen përsëri ndihma në njerëz, teknikë luftarake e logjistike. Ndërsa partizanëve pas katër orë luftimeve filluan tu mbaronin rezervat, por edhe tërheqja ishte e vështirë.

Midis Përbregut dhe Bardhocit u organizua tërheqja me luftim, por patëm të vranë e të plagosur. U plagosën Met Hajrullai, Azis Asllani etj.

Të nesërmen batalioni parë organizoi një aksion tjetër në fund të fshatit Morin ku asgjësohet plotësisht një kompani gjermane por u vra edhe partizani Eles Mena nga Bllaca. Pas tërheqjes nga Dragashi, batalioni i katërt ishte urdhëruar për të sulmuar kalanë e Prizrenit, ndërsa batalioni i parë do të sulmonte Zhurin. Brigada e

pestë do të sulmonte Prizrenin.

Pas gjashtë orë luftimesh Prizreni u çlirua. Pastaj të gjitha forcat partizane përqëndrohen për çlirimin e Kukësit. Forcat gjermane largohen dhe përqëndrohen në Shkodër. Ndërsa forcat e Brigadës sonë ndodhen në Luginën e Valbonës në Tropojë, njoftohemi me 29 nëntor se forcat partizane kanë çliruar Shkodrën.

Luftëm e vazhduam kundër forcave që komandohehin nga Halil Alia, Muharrem Bajraktari, Gjon Marka Gjoni. Në përpjekje me forcat e Halil Alisë u vranë 13 partizanë të batalionit të Tropojës.

Më 1 janar 1945 na u dha urdhëri për të kaluar në Mirditë, batalioni i parë dhe batalioni i katërt i Brigadës 18. Batalioni i parë do të kalonte qafën e Malit dhe batalioni i katërt do të kalonte Qafën e Kumbullës. Bota binte papushim dhe kishte arritur lartësinë dy metra. Duke kaluar qafën vdiqën katër partizanë. Tuneli i dëborës bllokohej në çast. Në krye të kollonës ishin Gafur Korça, Rexhep Doda, Albert Paporisto, Ferit Muha. Alberti ishte nga Elbasani dhe nuk ishte mësuar me dimra të tillë.

Asnjë shtëpi nuk duket në horizont. Jemi të lodhur e të djersitur. Po na humb edhe shpresa e ndonjë strehimi të afërt. Gjashtëqind partizanë rrezikohen të vdesin në dëborë nga të ftohtit, nga lodhja dhe nga uria. Ky acar ishte edhe më i keq se beteja. Kishim kaluar qindra beteja dhe nuk ishin sprapsur ndersa ky acar e kjo dëborë ishin të tmershme. Ato po na merrnin jetën ngadalë ngadalë. Papritmas hasi në murin e një avllie. U futëm brenda në kasollen e braktisur dhe ndezëm me shpejtësi një zjarr të madh për të shpëtuar nga ngrirja. Disa metra më larg pamë edhe një shtëpi. Ju drejtua, pjesa e mbetur, se një kasolle nuk mori vetëm dyqind burra. Ishte ora dy e natës dhe thirrja jonë në këtë natë të acartë nuk dëgjohej. Por pas disa thirrjeve e krismave të njëpasnjëshme u dëgjua një zë burri: Kush jeni? Jemi partizanë, ju përgjigjëm. Hajdeni Bujrum sa të jeni, u përgjigj i zoti i shtëpisë. Jemi shumë or mik. Do tju shpërndajmë në të gjithë fshatin me djemtë e mij, tha burri me bujari. Në shtëpinë e tij u strehua Ferit Lleshi, Hamdi Doda, Pali Carapuli, Sali Hoxha etj. Kështu u shpërndanë dhe kaluan natën të gjithë partizanët. Nuk bahej fjalë për të ngrënë, pasi as fshatarët nuk kishin ç'të hanin për vete, por vetëm për të futur kokën e për të shpëtuar nga ngrirja e nga vdekja. Pasi dëborë ngriu kalonim mbi dëborë dhe udhëtuam drejt Mallkuqes, Domgjonit, Iballës e Pukës.

Në organizimin e ri të pasluftës Brigada e 18 u caktua të shkonte e të shërbente në Gjirokastër.

*Veterani Uke A. Cami ka qenë komisar i kompanisë së parë të batalionit të parë të Br.18 S dhe kujtimet e tij i ka përmbledhur në librin me titull „Shpirti ynë liridashës“

PERSONALITETE

Në 105-vjetorin e lindjes të gjeneralit që u burgos dhe internua nga diktatura

GJENERAL NEXHIP VINÇANI, KOMANDANT DHE INTELEKTUAL I TALENTUAR

• Bilanci luftarak i Nexhip Vinçanit është shumë i pasur. Ai mori pjesë në 255 ditë luftime. Është plagosur në luftimet për çlirimin e Pogradecit dhe ka vdekur me plumbin në bark.

• Komandant Nexhipi ka drejtuar me aftësi të rrallë luftimet që ka zhvilluar Brigada e IV-t S në dy operacionet armike, atë të Dimrit dhe të Qershorit. Por beteja më e lavdishme e for-cave të brig.IV-t S ishte ajo për çlirimin e Tiranës

Nexhip Vinçani lindi në Vinçan të Korçës më 10 gusht 1916. Biri i atdhetarit të shquar Kareman Vinçani (Dervishi), pasi mbaroi shkollën fillore në Vinçan, filloi mësimet në Liceun e Korçës. Më pas vazhdoi mësimet në Shkollën Mbretërore Ushtarake në Tiranë dhe i përfundoi në Gjimnazin e Shkodrës në vitin 1939. Ishte shok i ngushtë i Qemal Stafës e Sadik Bekteshit.

Nexhip Vinçani, studimet universitare i kreu në Romë. Sa dëgjoi kushtrimin e Nënës Shqipëri, si gjithë bashkëmoshatarët u kthye në atdhe. Menjëherë, Nexhipi dhe shoku i tij i ngushtë, Pëllumb Dëshnica caktohen nga Qarkori i Korçës të organizojnë rezistencën dhe luftën kundër okupatorit Italian.

Familjen e Nexhipit e kishte përshkuar era e barutit në luftën për lirinë e atdheut që në kohën e luftës të rilindasve tanë të shquar për liri e pavarësi kombëtare. I jati i tij, Kareman Vinçani luftoi kundër rebelëve të Haxhi Qamilit. Ishte bashkëpunëtor aktiv i Themistokli Gërmenjit, pjesëmarrës në Kongresin e Lushnjës si përfaqësues i parë i n/prefekturës Korçë.

Karemani, mik e mbështetës i Fan Nolit, Themistokli Gërmenjit, Bajo Topullit e Mihal Gramenos, do të ishte dhe një antifashist i madh si anëtar i Këshillit të Përgjithshëm Nacion-alçlirimtar. At e bir qenë pjesëmarrës aktivë në luftën për çlirimin e vendit nga thundrra e fashizmit.

ORGANIZATOR I TALENTUAR I NJËSITËVE TË LANÇ

Më 28 Nëntor 1941, Pëllumb Dëshnica dhe Nexhip Vinçani folën në një miting kundër okupatorit. Pëllumbi u arrestua dhe u dërgua në Ventontene, Itali, ndërsa Nexhipi me ndihmën e shokëve i shpëtoi internimit.

Veprimtaria patriotike dhe atdhetare e Nexhip Vinçanit është shumë e madhe. Ai kishte aftësi, burrëri e trimëri të rrallë. Si organizator i përkryer i LANÇ e shtriu aktivitetin e tij nga fshati në fshat për të rizgjuar traditat patriotike në Qarkun e Korçës. Me pasionin e një nacionalisti demo-krat, që në qershor-shtator 1942 krijoi njësitë e armatosura në disa fshatra. Të tilla ishin Çetat e Gorës, Mestan Ujanikut, Gorë-Oparit, Malit të Thatë, Vithkuqit e Rrëzës, Kolonjës, Bilishtit e Mokrës me komandant Reshit Çollakun.

Nexhipi, i jati dhe vëllezërit Ali, Skënder, Sami, e Sali si dhe kushërinjë e tyre, dhanë një ndihmesë të madhe në organizimin e LANÇ në Qarkun e Korçës. Aliu - komandant çete në fillimet e luftës me pas komandant batalioni, Samiu - komisar batalioni, etj.

Për merita të veçanta në organizimin e LANÇ në Qarkun e Korçës, për aftësi organizuese dhe komanduese, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë Antifashiste Nacionalçlirimtare e emëroi komandant të Shtabit të Qarkut të Korçës.

Nexhip Vinçani, nga viti 1940 deri në maj 1943 ishte drejtues dhe organizator kryesor në Qarkun e Korçës, ko-



mandant dhe intelektual i talentuar. Në Qarkun e Korçës në fillim ai organizoi Njësitë e armatosura. Më vonë, në fillim të vitit 1942 deri në shtator të atij viti punoi në organ-izimin e çetave, si ajo e Pogradecit, Gorës, Vithkuqit etj, gjithsej 15 çeta partizane.

Në janar-mars 1943 numri i çetave sa vjen e shtohet. Baza politike e këtyre çetave ishin Këshillat Nacionalçlirimtare të zgjedhura nga populli, pothuajse në çdo fshat të Qarkut të Korçës.

ORGANIZIMI I USHTRISË TË RREGULLT PARTIZANE

Në maj 1943 filloi krijimi i Ushtrisë së rregullt partizane me krijimin e batalioneve me organika të plota. Numri i tyre në Qarkun e Korçës arriti në 8: Batalioni "Themistokli Gërmenji" (Rëzë), "Ali Këlmendi" (Gorë), "Tomori" (Opar), "Çlirimi" (Opar i Poshtëm), "Qamil Panariti (Vithkuq), "Hakmarrja" (Kolonjë), "Fuat Babani" (Devoll) dhe "Bat. Mokrës" (më pas-"Reshit Çollaku"). Krijimi dhe organizimi i kësaj force të madhe partizane për luftën kundër okupatorit italian e më vonë atij gjerman rritën më tej aftësitë organizuese e drejtuese të Nexhip Vinçanit, i cili afirmohet si personalitet politik i Ushtrisë Nacionalçlirimtare.

Mori pjesë si delegat i Qarkut të Korçës në Konferencën e Pezës bashkë me Ymer Dishnicën (kryetar) dhe Feta Butkën (përfaqësues i nacionalistëve). Në gusht 1943, në Vithkuq të Korçës formohet Brigada e Parë Sulmuese me mbi 60 % efektiv nga Qarku i Korçës. Ndërsa brigadat e IV-t, XV-të, IX-të, XX-të u formuan vetëm me efektiva nga Qarku i Korçës. Gjithë kjo forcë e madhe ushtarake, e formuar në Qarkun e Korçës tregon më së miri se komandant Nexhipi dhe komisar Pëllumbi, (për hir të së vërtetës) komandonin 1/5 e Ush-trisë NÇL të vendit.

Por le të ndalemi tek brigada e IV-t S e komanduar nga Nexhip Vinçani e Pëllumb Dëshnica.

Rruga luftarake e kësaj brigade është mjaftë e suksesshme. Qysh në formimin e saj më 28.12.1943 ajo nuk u mblodh për t'u inauguruar sepse kishte filluar Operacioni i Madh Ar-



mik i Dimrit 1943-44. Batalionet vinin në qendrën e grumbullimit dhe nuk kishin kohë të rreshtoheshin, por merrnin detyrat luftarake për të ndalur okupatorin gjerman që vinte nga drejtimi e Beratit, luginës së lu-mit Devoll, nga drejtimi i Korçës, Kolonjës dhe Pogradecit; komandant e komisar, Nexhipi e Pëllumbi organizuan bashkëveprimin dhe me forcat partizane të Qarkut të Beratit. Luftimet va-zhduan kundër forcave armike pjesëmarrëse në operacion për likuidimin e forcave të Brigadës së IV dhe gjithë Qarkut. Në këtë situatë shumë të vështirë të forcave partizane (dimri i egër, mungesa e ushqimeve e veshmbathjes, mjeteve e forcave) u mblodh Shtabi i Forcave dhe të deleguarit për të vendosur. Nën drejtimin e Koçi Xoxes, të deleguarit e Shtabit të Përgjithshëm që ishin prezent vendosën që forcat partizane të shpërndaheshin e të shkonin në prapavijat e rrethëve të tyre, për t'u riorganizuar në pranverë (sikundër ndodhi me brigadat e tjera (veç Br. I-ë). Në mbledhje merr fjalën edhe komandant Nexhipi, i cili argumentoi dhe bindi Shtabin e të deleguarit, për të marrë përsipër çarjen e rrethimit dhe nxjerrjen e forcave të Brigadës në zonën e lirë parti-zane të Beratit. Në këtë situatë shumë të vështirë spikati dhe njëherë aftësia dhe talenti i koman-dant Nexhip Vinçanit, i cili duke dhënë Urdhërin Luftarak për katër batalionet që të kalonin në kundërsulm në tre drejtimet që pengonin avancimin e forcave armike, me zgjuarsi kapi lartësitë sunduese me drejtim kryesor, sidomos Qafën e Becit. Gjithë forcat partizane kaluan në zonën e lirë të Skraparit. Ky veprim pati efekt jashtzakonisht të rëndësishëm, përkundrejt propagandës kundërshtare për gjoja, "dështimin dhe shpartallimin e Ushtrisë NÇL".

KOMANDANTI QË MORI PJESË NË 255 DITË LUFTIME DHE BËRI 220 KM RRUGË

Bilanci luftarak i Nexhip Vinçanit është shumë i pasur. Ai mori pjesë në 255 ditë luftime. Është plagosur në luftimet për çlirimin e Pogradecit

dhe ka vdekur me plumbin në bark. Komandant Nexhipi ka drejtuar me aftësi të rrallë luftimet që ka zhvilluar Brigada e IV-t S në dy operacionet armike, atë të Dimrit dhe të Qershorit. Ka marrë pjesë në luftimet e Divizionit të I-rë S nga Jugu, Shqipëria e Mesme e deri në Veri, duke përballuar me sukses ofensivën e forcave armike në zonën e Matit e Dibrës. Po kështu dhe në operacionin "Syri i Kaltër", operacionin për çlirimin e Peshkopisë që solli dhe dështimin e forcave gjermane si dhe luftimet në qarkun e Elbasanit në shtator 1944. Por beteja më e lavdishme e forcave të brig.IV-t S ishte ajo për çlirimin e Tiranës, kryeqytetit të Shqipërisë. Brigada e IV-t u caktua të sulmojë në pjesën jugore duke filluar nga Ko-dra e Kopilit (sot Varrezat e Dëshmorëve të Kombit) e kodrat në jugperëndim të qytetit deri në Kodrat e Yzberishtit. Komandant Nexhipi u caktua Zv. Komandant i Shtabit Operativ për çlirimin e Tiranës. Luftimet e Brigadës së IV-t S ishin shumë të suksesshme.

DIKTATURA IA MOHOI MERITAT GJENERAL VINÇANIT

Pas çlirimit të vendit, për merita të shquara gjatë LANÇ, Nexhip Vinçani iu dha grada Kolonel e më pas Gjeneral-Major. Mbasi kreu me sukses Akademinë ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm "Voroshillov" në BS, Nexhipi dha një kontribut të çmuar për modernizimin e Ushtrisë Shqiptare. Caktohet Zëvendës Shef i Shtabit të Përgjithshëm dhe më 1956 Komandant i Mbrojtjes Bregdetare. Mirëpo, gjithë vlerat e gjeneral Vinçanit, pas çlirimit filluan të zbehen dhe të mohohen, duke e spostuar gradualisht dhe cilësuar "antiparti", nga diktatura e Enver Hoxhës dënohet padrejtësisht, duke e larguar përfundimisht nga Ushtria. Njëkohësisht dhe familja e Nexhipit, Karemanit, Aliut, Skënderit, Samiut dhe Saliut u përndoqën e u persekutuan nga sistemi i diktaturës. Vetë Nexhipi, tashmë pensionist dhe i sëmurë, burgoset dhe mbahet padrejtësisht rreth një vit në hetuesi. Në va-zhdim, internohet në Grabovë të Gramshit për 5 vjet. Vuajtjet në burg dhe në internim i shkurtuan jetën.

Vetëm ardhja e demokracisë bëri që gjenerali i talentuar Nexhip Vinçani të vlerësohet e të integrohet në jetën e pakët që i kishte mbetur. Në një nga përvjetorët e Brig.IV-t në Korçë merr pjesë dhe iu flet bashkëluftëtarëve si komandanti i tyre i dikurshëm, i mohuar nga diktatura.

Nexhipi është nismëtar i krijimit të Organizatës të Bashkuar të Veteranëve të LANÇ (OBVL) dhe si anëtar i kryesisë dha një kontribut të shquar në forcimin e saj. Vdiq në Tiranë më 06.02.1977 duke lënë për historinë e brezat veprën dhe emrin e tij.

Nder dhe lavdi komandantit, gjeneralit të talentuar Nexhip Vinçani.

*Shkruara nga Myfit GUXHOLLI, ish-partizan i Brig.IV-t S

SPECIALE

Libri i Dr. Femi Sufaj për sistemin e burgjeve 1912-1990, vlerë e shtuar në fondin e letërsisë dokumentare

Burgjet shqiptare në monarki, gjatë

• Shqipëria gjatë 45 viteve pas çlirimit nga nazistët, përjetoi një prej prej diktaturave komuniste më të egëra në Europë. Gjatë kësaj periudhe u ekzekutuan për motive politike 5037 burra dhe 450 gra. Janë dënuar me burg, ose dërguar në kampet e punës së detyruar 19250 persona dhe kaluan në kampet e internimit 48217 burra dhe 10792 gra.

Nga Halil Rama – Mjeshtër i Madh

(vijon nga fq.1)

Kështu, në këtë libër, krahas referencave nga personalitete të jurisprudencës e publicistikës shqiptare, si “Zhviillimi historik i Legjislacionit Penal në Shqipëri” (Ismet Elezi); “Politika kriminale” (Ismet Elezi&Vasilika Hysi); “Historia e Shqipnis” (Tajar Zavalani); “Stalinizmi shqiptar” (Arshi Pipa) etj, autori perifrizon dhe komenton edhe Bernard Fischer (“Përpykjet e Mbretit Zog për Stabilitet në Shqipëri”; Nelson Madela (“Rruga e gjatë drejt lirisë”), Pol Xhonsen (“Kohët moderne”), Edëin Jacques (“Shqiptarët”), Roberto Moroco dela Roka (“Kombi dhe feja në Shqipëri”), Hannan Arendt (“Origjina e Totalitarizmit”) etj.

SISTEMI I BURGJEVE, NGA QEVERIA E VLORËS DERI TEK MONARKIA

Në pjesën e parë të librit “Vështrim historik mbi dënimet 1912-1944”, autori ndër të tjera na njeh me faktin se për funksionimin normal të drejtësisë, Qeveria e Vlorës, deri në krijimin e kodeve dhe ligjeve shqiptare vendosi të zbatojë Kodin Penal Otoman të vitit 1878.

Nën këtë optikë Dr.Femi Sufaj argumenton se si nga sundimi i gjatë otoman, Shqipëria trashëgoi një sistem të ashpër burgjesh, të cilët kishin shërbyer për izolimin jo vetëm të shkelësve të ligjit, por edhe të shumë patriotëve, të cilët luftonin për pavarësi politike dhe për gjuhën e shkollën shqipe.

Burgjet kryesore, sipas autorit, ishin ngritur në qytetet më të mëdha si në Janinë, Manastir, Prizren, Shkodër, Gjirokastrë, Elbasan. Me tej autori na njeh me faktin se “Forcat austro-hungareze dhe franceze që u vendosën në Shqipëri gjatë Luftës së Parë, kaluan nën varësinë e tyre administratën e vendit dhe filluan të adoptojnë kodet dhe ligjet e tyre edhe në administrimin e burgjeve”.

Nga shqyrtimi i dokumentave arkivore të kësaj periudhe, konstatohen disa urdhëresa të komandës austriake në të cilat përcaktohet diçka ditore për çdo të dënuar, si dhe e drejta e të dënuarve për të blerë me mjetet e tyre financiare.

Plotësimi i kuadrit ligjor për të dënuarit ka vijuar me ligjin e Këshillit të Naltë të datës 31.01.1923 “Për përdorimin e të burgosurve për punë”. Referuar fakteve arkivore autori Sufaj pohon se pas shpalljes së Shqipërisë Republikë dhe më 1928 Monarki, kompletohet kuadri ligjor i institucioneve të shtetit shqiptar.

Krahas Statutit Themelor (Kushtetutës), më 3 qershor 1927 ishin miratuar Kodi Penal, Kodi i Procedurës Penale, Kodi Civil, Kodi Penal Usharak, u bë organizimi i drejtësisë me përcaktimin e kompetencave të Gjykatës Paqtuese, Fillore, të Diktimit si dhe organizimi i avokatisë. Në Kodin Penal ishin parashikuar disa alternativa dënimi, si dhe lirimi me kusht.

Më 18 gusht 1933 hyri në fuqi Rregullorja e re e Burgjeve e miratuar nga Këshilli i Ministrave. Në Kodin penal ishte parashikuar edhe dënimi me heqje të lirisë për femrat.

Në nenin 24 të këtij kodi thuhej: “Gratë, ndëshkimet me burgim të përjetshëm, me burgim të rëndë, me burgim dhe me burgim të lehtë i vuajnë në stabilitet (godina) të destinuar për to”.



PAK HISTORI NGA DR.FEMI SUFAJ

Duke marrë parasysh gjendjen e vështirë të sistemit të burgjeve, Kolonel Stirling më 1924 propozon ngritjen e dy burgjeve të përgjithshëm, ku të vendosen nga 450 të burgosur të dënimeve të gjata dhe një personel i mjaftueshëm për sigurimin dhe trajtimin e të dënuarve. Kavaja dhe fortësia e Gjirokastrës, mendoheshin si vendet më të përshtatshme. Sipas këtij propozimi, projektet duhet të përmbanin ambiente për punë ku të dënuarit të mësojnë mjeshtëri të ndryshme, ambiente mësimi, dhe mjekimi. Konstruksioni i burgjeve ka ndryshuar vazhdimisht në varësi të nivelit ekonomik e politik dhe të kushteve që duhet të përmbushin. Pavarësisht modeleve të ndryshme që paraqiten në këtë drejtim, tre janë kushtet kryesore që duhet të plotësojë konstruksioni i burgjeve: Sigurimin e të dënuarve, higjienën dhe rehabilitimin e tyre. Për ndërtimin e burgut të Kavajës ishte hartuar një projekt austriak në vitin 1924. Ndërtimi i këtij burgu nuk u realizua, ndoshta u pa më i favorshëm ndërtimi i burgut të Tiranës më 1930. Në qytetin e Tiranës kanë funksionuar dy burgje, një për të dënuarit politik dhe tjetri për të dënuarit e zakonshëm. Si burg politik deri në vitin 1930 ka shërbyer një shtëpi private në pronat e Toptanësve dhe më vonë në lagjen “Sulejman Pasha”. Në dokumentat arkivore përmenden edhe banesa të tjera. Në një raport që Ministria e Drejtësisë i bën Ministrisë së Brendshme me 17.09.1921 mbi burgun e Tiranës midis të tjerave shkruhet: “... Në tri dhoma që ka burgu me shtërngim të madh, ishin 67 vetë.70 të burgosur flenin përjashtë në oborr e disa nën strehë. Në këtë mënyrë rrojtje i duket njeriut si me qenë dënuar me vdekje me mundim. ...Kjo është despotizëm, një sjellje kundër jetës njerzore”.

Në vitin 1926 nga të dhënat e Ministrisë së Brendshme llogariteshin rreth 500 persona të cilët kishin kryer vepra të rënda penale. Nga këta 128 ishin duke vuajtur dënimin në burgje dhe të tjerët ndodheshin në kërkim. Për mbajtjen e tyre Qeveria kishte planifikuar adaptimin e kalasë së Porto Palermos dhe të Gjirokastrës si më të sigurta për ruajtjen e të dënuarve. Rikonstruksioni dhe adaptimi i kalasë së Gjirokastrës u bë më 1928, ku u përfutuan 50 dhoma të vogla në formë qelish që merrnin 3-4 veta secila, një sallë e madhe, një dhomë për spital,



ambiente për drejtorinë, takimet me familjarët, gardianët etj. Burgu kishte disa qeli të sigurisë së lartë për elementë problematikë, siç emërtohen në projekt “dhomat për katilat”. Kapaciteti i burgut ishte deri në 330 vetë, ndërkohë ku nga informacioni i drejtorit të burgut të datës 29.02.1932 mësojmë se në këtë burg ishin 224 të dënuar. Kushtet e jetesës në këtë burg ishin shumë të vështira. Për ta kuptuar më mirë këtë ferr po japim në fundshënimet pjesë nga raporti i Kryeinspektorit të Oborrit Mbretëror të datës 07.03.1932 që inspektonte Burgun e Gjirokastrës.

Në qytetin e Shkodrës ndodhej një nga burgjet më të mëdhenj, i cili kishte funksionuar edhe gjatë sundimit turk. Nga të dhënat e vitit 1929 mësojmë se Burgu i Shkodrës kishte 7 dhoma me 151 të dënuar meshkuj, një dhomë për të dënuara femra një dhomë për punë, një për shkollë dhe një për spital. Nga një relacion i Prokurorisë së Shkodrës më 16.01.1935 bëhet e ditur se në këtë burg ndodheshin 338 të burgosur nga të cilët 146 të dënuar me vendim të formës së prerë, 182 të paraburgosur, 9 të burgosur për borxhe dhe një për politikë. Kapaciteti i burgut ishte për 270 të dënuar. Në çdo dhomë qëndronin 60-70 vetë. Në këtë gjendje ishte edhe burgu i Kukësit, në të cilin mbaheshin 77 të burgosur në 4 dhoma. Në vitin 1930 u ndërtua Burgu i Tiranës, në rrugën e Shkodrës, sot rruga “Mine Peza”. Kapaciteti i tij ishte deri në 300 të dënuar, por kjo shifër duhet të konsiderohet relative, duke parë standartet e jetesës dhe kushtet higjieno-sanitare. Ish i burgosuri politik Haki Stërmilli i cili vuante dënimin në këtë burg e përshkruan në këtë mënyrë “...nuk është i përshtatshëm për burg pasi nuk është ndërtuar sipas dispozitave ligjore, këtu rrinë fajtorët politik bashkë me ata ordiner, vrasësi me hajdutin, debitori me falsifikatorin, plaku me të riun etj. Për këtë shkak, burgu është bërë si një farë shkolle ku mësohet kriminaliteti e jo një institucion ku shtypet e zhduket ky ves i ligë”. 26 Në vitin 1939 përfundon ndërtimi i Burgut të Burrelit, i cili kishte një kapacitet prej 150 të burgosur. Burgu ishte ndërtuar në periferi të qytetit dhe zinte një sipërfaqe prej 1.3 hektarë. Në konstruksion ishin parashikuar pak a shumë të gjithë kërkuesat që duhet të përmbushen në lidhje me sigurinë dhe trajtimin e të dënuarve. Për kurimin e të dënuarve të sëmurë u ngrit një

DEKRETI

Luftës së II Botërore dhe në diktaturë

spital në Tiranë, i cili do të shërbente edhe për observimin e të dënuarve që dërgoheshin nga gjykata. Në Voskopojë dhe në Porto Palermo ndodheshin dy qendra kurative për të dënuarit e sëmurë.

BURGJET SHQIPTARE GJATË LUFTËS SË II BOTËRORE

Si njohës perfekt i Të Drejtës penale, Dr.Femi Sufaj pohon se Dispozitat ligjore penale të krijuara në kohën e Republikës dhe të Monarkisë shqiptare mbetën në fuqi edhe gjatë periudhës së pushtimit fashist, me disa ndryshime të vogla në përshtatje të kushteve të reja.

Referuar burimeve të sakta arkivore ai bën të ditur se për drejtimin e sistemit të burgjeve më 17.12.1942 krijohet Drejtoria Qendrore Penitenciare. U krijua kartoteka ku do të mbaheshin të gjithë fashikujt e të dënuarve. Më 27.12.1942 doli dekreti i Mëkëmbësisë së Përgjithshme që bën një modifikim të rregullores së vitit 1933 për trajtimin e të dënuarve. Kompetencat e këshillit vrojtues do të pakësoheshin. Ruajtja e të dënuarve do të bëhej nga reparatet e milicisë.

Referuar të dhënave arkivore, Dr.Sufaj pohon se Drejtoria Qendrore Penitenciare në vitin 1943 kishte në administrim të gjitha burgjet shqiptare që ishin brenda dhe jashtë kufive të caktuar më 1913. Burgjet kryesore shqiptare, sipas një raporti të kësaj drejtorie ishin: Tirana 2, Vlora 1, Peja 1, Durrës 1, Gjirokastra 1, Prishtina 1, Shkodra 1, Korça 1, Prizëreni 1, Elbasani 1, Burreli 1, Tetova 1, Peshkopia 1, Berati 1, Dibra 1 dhe Kukësi 1.

“Gjatë luftës çlirimtare antifashiste, krahas dispozitave ligjore penale të strukturave shtetërore dhe të pushtuesve kemi disa akte që janë nxjerrë nga strukturat e lëvizjes antifashiste. Rezoluta e Konferencës së Pezës në detyrat e këshillave çlirimtare përfshinte edhe luftën kundër kriminalitetit dhe mbajtjen e qetësisë në zonat e çliruara. Në Rregulloren e Këshillave Nacionalçlirimtare të vitit 1943, 22 në vendime të ndryshme dhe urdhëra të Shtabit të Përgjithshëm janë parashikuar dënime të ashpëra për prishje të rendit dhe thyerje të rregullave të luftës”, shkruan dr.Sufaj. Ai sjell fakte për dënimet që janë dhënë nga strukturat e lëvizjes antifashiste të cilat kanë qenë të rrepta dhe kryesisht dënime me vdekje.

Në burgjet dhe kampet e Shqipërisë gjatë kësaj periudhe kanë qenë 8117 persona.

Ndërkohë, në burgjet dhe kampet e Italisë ishin 5297 shqiptarë; në Gjermani (në 20 kampe përqëndrimi) 2581 shqiptarë; në Austri (Mathauzen) 440 shqiptarë; në Poloni (Austvic) 39 shqiptarë; në burgjet e Greqisë 500 shqiptarë; në burgjet e Jugosllavisë 295 shqiptarë, në burgun e Prishtinës 629 shqiptarë dhe në Maqedoni (Bitol) 144 shqiptarë. Nga 18042 të burgosur dhe të internuar gjithsej, 879 vetë u ekzekutuan me mënyra të ndryshme.

AMNISTITË

“Në harkun kohor 1912-1944 janë bërë disa amnisti, të cilat lidhen me ngjarje të rëndësishme dhe ndryshime të situatës politike. Me propozim të Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Naltë me 01.11.1921 aprovoi amnisti për të gjitha krimet e kryera gjatë pushtimit turk dhe grek. Kjo amnisti motivohej nga fakti, se ishte prishur dokumentacioni i procedimit penal gjatë luftës dhe drejtësia e kishte të vështirë të siguronte provat e nevojshme. Amnistia e dytë e madhe u bë me rastin e shpalljes së Republikës shqiptare, e cila falte të gjitha krimet ordinere dhe krimet për çështje nderi që ishin kryer deri më 21.01.1925. Më 19.09.1928 u bë një amnisti tjetër e madhe me rastin e shpalljes së Monarkisë. Me vendosjen në vend të trupave të pushtimit më 1939 dhe në shtator 1943 përfituan lirinë një pjesë e të dënu-



arve ordinerë dhe politike, në sajë të amnistive politike që u dhanë nga pushtuesit. Nuk jemi në gjendje të japim të dhëna të sakta në lidhje me numrin e personave që kanë fituar lirinë në saj të faljeve apo amnistive, për mungesë të dhënash si dhe për faktin se amnistitë dhe faljet ishin praktika të zakonshme që përsëriteshin vazhdimisht. Këtë e nënvizon dhe studiuesi i historisë së Shqipërisë B.Fischer, sipas të cilit, ashtu si në të kaluarën, të paktë ishin ata të dënuar që dënoheshin me 101 vjet burgim dhe që bënë më shumë se disa vjet burg”,-shkruan Dr.Femi Sufaj.

SISTEMI I NDËSHKIMEVE NË SHQIPËRI GJATË REGJIMIT KOMUNIST (1945-1990)

Në kapitullin “NGRITJA E SISTEMIT TË DREJTËSISË PENALE GJATË VITEVE 1945-1952 autori evidenton dhe kumton katër periudha kohore: Instalimin e shtetit komunist; Ngritjen e Institucioneve të sistemit të drejtësisë penale; organizimin e Gjqejeve politike speciale si dhe në krijimin e bazës ligjore të sistemit të drejtësisë. Tronditës fakti që sjell autori se “Në ligjin e datës 15.12.1944 mbi sabotatorët e luftës dhe të pushtetit popullor parashikoheshin dënime deri në 30 vjet burg, dënim të përjetshëm dhe me vdekje. Përveç arrestimeve, burgosjeve dhe vrasjeve, u bë edhe sekuestrimi i pasurisë së të gjithë personave që shpallëshin kriminel lufte. Numri i personave të kësaj kategorie të dokumentuar arrin deri në 2048 persona, të cilët i përkasin periudhës brenda vitit 1945.

Autori sjell gjithashtu një Statistikë mbi kapacitetin e burgjeve më 1 janar 1951 shifrat e së cilës janë vërtetë tronditëse. Kështu në burgin e Tiranës ndodheshin 902 të burgosur politikë, ose 615 mbi kapacitetin e tij; në burgun e Elbasanit 216 të burgosur politikë (53 mbi kapacitetin e tij) dhe në burgun e Korçës 353 të burgosur politikë ose 132 mbi kapacitetin e tij.

Ndërsa në kapitullin e dytë: “SISTEMI I DREJTËSISË GJATË PERIUDHËS 1952-1966”, Dr.dmi Sufaj përqëndrohet tek Forcimi i luftës së klasave; Intensifikimi i përpjekjeve për rrëzimin e regjimit komunist (1949-1953), Dënimet politike pas Konferencës së

Tiranës (1956) si dhe tek Forcimi i karakterit represiv të burgjeve dhe kampeve.

Më tej, në kreun e III-të “POLITIZIMI I ORGANEVE TË DREJTËSISË” autori, duke iu referuar zhvillimeve politike të harkut kohor 1966-1976 jep fakte dhe komente për ashpersimin e situatës politike të vendit, eliminimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe mbrojtjes ligjore, ndërkohë që iu kushton vëmendje të vecantë gjyqeve kundër fesë dhe shkatërrimi i strukturs se besimit, si dhe Internimeve dhe dëbimeve.

Për lexuesin, të një rëndësie të vecantë janë artikuljt e kapitullit të katërt “ZHVILLIMET NË SISTEMIN E DREJTËSISË NËN NDIKIMIN E KUSHTETUTËS SË VITIT 1976, ku autori me kompetencë profesionale konsideron Kushtetutën e vitit 1976 si dëshmi të shkatërrimit të shtetit ligjor; Kodin Penal të vitit 1977 si instrument i luftës së klasave, ndërkohë që trajton me fakte dhe argumente krizën e sistemit të drejtësisë në vitet 1970-1980.

DISA FAKTE RRËQETHËSE

- Me 3 korrik 1946 Gjykata e Lartë Ushtarake dënoi me vdekje me pushkatim përfaqësuesit dhe drejtuesit kryesor të organizatës Bashkimi Demokrat. U arrestuan 37 shtetas dhe u dënuan me vdekje 9, të tjerët me dënime të rënda.
- Në shtator të vitit 1947 u zhvillua gjyqi i deputetëve i cili dënoi me vdekje varje në litar tre intelektualë: Shefqet Beja, Riza Alizoti, dhe Sulo Klosi. U dënuan me pushkatim 13 intelektualë.
- Shqipëria gjatë 45 viteve pas çlirimit nga nazistët, përjetoi një prej prej diktaturave komuniste më të egëra në Europë. Gjatë kësaj periudhe u ekzekutuan për motive politike 5037 burra dhe 450 gra. Janë dënuar me burg, ose dërguar në kampet e punës së detyruar 19250 persona dhe kaluan në kampet e internimit 48217 burra dhe 10792 gra.

REFERENCA PËR RISHKRIMIN E HISTORISË

Libri i Dr.Femi Sufaj “Sistemi i ndëshkimeve në Shqipëri gjatë regjimit komunist” (1945-1990) duhet konsideruar nga Komisioni i krijuar nga Akademia e Shkencave për rishkrimin e historisë. Kjo për faktin se në të ka fakte dhe dokumenta arkivore që dëshmojnë për një nga aspektet më të errëta të historisë sonë kombëtare.

Në harkun kohor të dy dekadave të fundit Dr.Femi Sufaj ka shkruar dhe botuar monografi: “Historia e burgjeve të Shqipërisë gjatë sh.xx” botuar viti 2000, dhe Sistemi i ndëshkimeve në Shqipëri gjatë regjimit komunist (1945-1990). Përvoja e gjatë në strukturat drejtuese të DPB për gati 30 vite dhe si lektor në UT, fakulteti shkencave sociale për shume vite është reflektuar edhe në disa artikujt dhe manuale trajnimi profesional.

Në kuadrin e rishikimit të historisë së sotme të Shqipërisë dhe veçanërisht të periudhës komuniste, në këto dy monografi ai hedh dritë në një aspekt shumë të rëndësishëm të historisë së vendit tone. Informacioni dhe të dhënat që ofrohen nga kjo vepër me vlera të rralla shkencore, janë burim për analiza të mëtejshme të studjuesve dhe kërkuesve të rinj të cilët do të kontribuojnë për pasqyrimin sa më të plotë të aspekteve të dënimeve penale gjatë diktaturës komuniste. Brezat të cilët nuk e kanë jetuar atë kohë dhe ata që do të vinë, do të kuptojnë më mirë rolin e diktaturave në manipulimin dhe përdorimin e qenjes njerzore në shërbim të një interesi, i quajtur i përgjithshëm, por në fakt ishte i një kaste sunduese të përhershme.

PROFIL

MIRËNJOHJE PËR ROLIN DHE KONTRIBUTIN E ISH – KOMANDANTIT TË BATALIONIT IV të Br.XVII

MUHARREM ÇOTA (HOXHË ÇOTA), FIGURË E SHQUAR E TREVËS SË LIBRAZHIMIT

Lavdim Çota & Zabit Çuku - Studues

Në Qarkun e Elbasanit ka zhvilluar aktivitetin një nga patriotët, luftëtarët dhe personalitetet e shquar i kësaj zone Muharrem Çota ose i njohur ndryshe Hoxhë Çota.

Hoxhë Çota ka lindur më 16 gusht 1904. Ishte djali i tretë nga pesë djem që kishte Hamit Çota. Familja e madhe e Çotajve u shpërngul nga Elbasani për në Hotolisht, Librazhd në fund të shekullit të 18-të. Hoxha u rrit dhe u edukua me ndjejat më të larta të atdhedashurisë, të trashëguara nga brezi në brez prej familjes, rrethit e tarafi miqësor.

Shërbimin ushtarak e kreu në zonën e Shkodrës dhe komandant i tij ishte Spiro Moisiu, një ushtarak karriere, patriot i madh, që më pas do të bëhej drejtuesi kryesor ushtarak i Lëvizjes NÇ dhe komandant i Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë partizane. Spiro Moisiu dalloj tek Muharremi një njeri trim, patriot e të ndershëm që nuk bënte dot kompromis me padrejtësinë. Gjatë kohës së shërbimit ushtarak, Hoxhën e arrestojnë pasi refuzon bashkë me disa shokë të tij të mbanin uniformat me dekoracione fashiste. Komandant Spiro e viziton në qeli dhe e instrukturon si të mbrohet në gjyq. “Në gjyq o trim mbrohu me idenë që besimi im fetar nuk më lejon të mbaj këto simbole”. Prej kësaj kohe lindi një miqësi që u mbajt deri në fund të jetës pavarësisht nga pazicionet dhe detyrat që kryen pas çlirimit të Atdheut.

Në fund korrikun e vitit 1943, në pragun e kapitullimit të italisë fashiste, njësitet guerrile të Elbasanit shpërthyen burgun e Elbasanit, ku Hoxha së bashku me dy djemtë e xhaxhait të tij, Ymer e Rrahman Çota gjendeshin të burgosur. Aktiviteti antifashist i Hoxhës ishte i njohur në burg, ku edhe aty, informohej për situatën në të cilën ndodhej vendi, por dhe për aktivitetin e antifashist dhe përpunimin e rekrutimit e sa më shumë njerëzve për të mbështetur lëvizjen.

Dalja e Hoxhës nga burgu u kthye në një manifestim jo vetëm për familjen dhe të afërmit, por për miq e fshatarë të shumtë nga Qarrishta, Dragostunja, zona e Mokrës dhe Çermenikës.

Në Labinot të Elbasanit u takua përsëri me Spiro Moisiun, ish komandantin e tij.

Hoxha u inkuadrua në batalionin partizan të Bërzeshës me komandant Lyto Leka. Batalioni kishte partizanë nga zona e Librazhdit dhe e Mokrës. Në fillim Hoxha kryeu detyrën e komandantit të kompanisë, më pas me detyrën e zëvendëskomandantit të batalionit. Detyra luftarake bëri të kishte kontakte dhe lidhje me Lyto e Sami Lekën, Dhimitër Shuteriqin, Petrit Hakanin, Qamil Guranjakun, Kadri Hoxhën, Zaim Miftari, Vebi Hoxhën, si dhe me drejtuesit kryesorë të LANÇ-it.

“OPERACIONI I DIMRIT 1943-1944

Forcat gjermane filluan “Operacionin e Dimrit 1943-1944”, me një ofensivë dhe terror të paparë ndaj Lëvizjes NÇ. Në këtë operacion në krah të tyre u rreshtuan forcat balliste dhe kolaboracioniste. Batalioni partizan i Bërzeshës u vu në një pozitë shumë të vështirë, ashtu si të gjitha formacionet partizane. Forcat balliste duke bashkëpunuar me gjermanët ushtruan veprime terrori ndaj gjithë atyre që ndihmonin me ushqim ose strehim partizanët. Shtabi i Përgjithshëm i ushtrisë NÇ dhe misioni anglez, kishin ngelur të rrethuar në malësitë e Çermenikës.

Rreth datës 7 janar 1944 misioni anglez dhe Shtabi i Përgjithshëm ishin pranë kapjes në zonën e Kostenjës nga gjermanët dhe ballistët e Azis Biçakut. Pati një debati të ashpër ndërmjet



krerëve të misionit anglez dhe Enver Hoxhës, për të nisur marshimin në drejtim të Jugut (të kalonin lumin Shkumbin dhe të hidheshin në malësitë e Elbasanit e më pas të Gramshit). Gjenerali nuk pranon të lëvizë nëpër natë, pasi ishte shumë e rrezikshme në një zonë që kontrollohej totalisht nga gjermanët dhe ballistët. Për më tepër ishte e pamundur të kalohej lumi Shkumbin, i cili kishte prurje të jashtëzakonshme dhe ato pak ura që ishin, ruheshin me rreptësi nga gjermanët.

Atë natë ata ndahen, Enveri me pjesën e shtabit të mbetur, pasi asgjësoi materialet që nuk mund ti merrnin me vete, u nis në drejtim të Jugut. Gjenerali qëndroi dhe të nesërmen ra në përpjekje me forcat që drejtoheshin nga Azis Bicaku. Reginald Hilbert në librin e tij “Fitorja e hidhur” ka shkruar: “Ai moment përcaktoi në mënyrë decisive fatin e palëve në luftë dhe pas saj. Nëse Shtabi i Përgjithshëm dhe Enver Hoxha nuk do të kishin marrë aventurën të lëviznin atë natë do kishin pasur fatin e gjeneralit. Por ata shpëtuan dhe jua kthyen reston ballistëve në mënyrë më të tmershme, vetëm disa muaj më vonë duke i shkatërruar totalisht ose i detyruan të iknin në ekzil”.

Pasi plagoset, gjenerali Dejvis, bie në dorë të ballistëve të cilët ngazëllehën me atë që kishin bërë, jua dorëzojnë gjermanëve. Krerët e BK në Tiranë, me në krye Mit’hat Frashërin kur e morën vesh se çfarë kishte bërë Azis Bicaku tmerrohen, por ishte vonë.

DETYRA E BR. I S PËR SHPËTIMIN E SHTABIT TË PËRGJITHSHËM

Më 11 shkurt 1944, në Kapinovë të Beratit, komandani i Br. I S Mehmet Shehu mori nga Shtabi i Përgjithshëm detyrën e re luftarake për t’i ardhur në ndihmë Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ. Në detyrë thuhej se Komanda e Shtabit të Përgjithshëm kishte mbetur e bllokuar në malet e Shëngjergjit dhe Orenjës të Çermenikës. Prandaj, duhej të arrinte objektivin e caktuar dhe të siguronte kthimin e kësaj pjese të shtabit në Jug. Në letër theksohej se “Shtabi i Përgjithshëm ka ngelë i izoluar, jeton nëpër pyje.

Ka rënë disa herë në përpjekje me gjermanët dhe ballistët. Shpëtimin e Shtabit duhet ta bëjë Br. I S. Detyra të mbahet shumë konspirative dhe të mos e dijë kush veç shtabit të Brigadës”.

Detyrën e ngarkuar, shtabi i brigadës vendosi ta kryente jo me të gjitha forcat, por me tre batalione, me një efektiv prej 450 partizanë, të komanduar nga komandanti i brigadës Mehmet Shehu. Batalionet që do të kryenin këtë detyrë luftarake komandoeshin: batalioni i parë-komandant Ndreko Rino dhe zëvendëskomandant Xheladin Beqiri (Karadaku), komisar Ndreçi Plasari; batalioni i dytë-komandant Ferit Radovicka, dhe komisar Lym Shyri (dëshmor), batalioni i tretë nga komandant Gjeli Argjiri dhe komisar Gaqo Shosho. Detyra luftarake u mbajt shumë sekrete.

Në orën 14.00 të datës 26.2.1944, tre batalionet e brigadës u rreshtuan në një shesh të mbuluar me borë, në katundin Çezmë të Mokrës. Duke vlerësuar situatën e rëndë nga moti i ftohtë me dëborë dhe acar, komandanti i brigadës vendosi tu komunikoi detyrën luftarake efektivit, dhe shprehimisht u thotë : “Shtabi i Përgjithshëm na ka ngarkuar me një mision me shumë rëndësi. Kjo barrë i ngarkohet Brigadës së Parë. Përpara nesh mdodhen pengesa gati të pakapërcyeshme, porse ne duhet t’i kapërcejmë; do të udhëtojmë shumë larg, do të kapërcejmë lumenj, male me borë, do të udhëtojmë me ditë dhe me netë të tëra, pa bukë, pa gjumë, zbatuar e zhveshur; kështu siç jemi do të ndodhemi në zona të sunduara nga forcat e Ballit, të rrethuar nga ballistë e gjermanë. Kjo është gjendja përpara nesh. Tashti, secili nga ju të mendohet mirë, para se të flasë, dhe të gjithë ata që nuk e shohin veten në gjendje të marrin pjesë në këtë marshim, të dalin mënjane e të mbeten këtu në Mokër”.

Mënyra me të cilën komandanti Brigadës u komunikoi detyrën luftarake, i elektrizoi partizanët, dhe rreshtimi i forcave u kthye përnjëherë në një miting të fuqishëm. Brohoritjet e partizanëve tregonin vendosmërinë e tyre.

Pasi lanë në Mokër prapavijat e batalioneve dhe disa partizanë që ishin të sëmurë, me gjithë furnizimet e tyre, në ora 15.00 të 26 shkurtit, forcat filluan marshimin drejt Qukësit.

Çfarë ndodhi dhe si kaloi në veri Br. I S, kur të gjitha shtigjet ishin të zëna dhe informatorët e armikut ishin në çdo vend?

Me marrjen e informacionit për marshimin e Br. I S, Hoxhë Çota duke ushtruar autoritetin e tij mori takim me njerëzit më me reputacion, që nuk ishin lidhur me Ballin nga Mokra deri në Qarrishtë. Bëri takime intensive me krerët dhe përfaqësuesit e fshatrave ku do të kalonte Br. I S në inkursionin e saj, për të bindur njerëzit që të mos pengonin dhe të mos sulmonin forcat partizane, pasi BK kishte shpërndarë armë dhe kishte dhënë urdhër që të qëllohet çdo person apo grup i armatosur që do të kalonte nëpër fshatrat e tyre. Ai ju afrooi si garanci banorëve që në rast se nuk do të godisnin kollonën e Br.IS, ata (partizanët) nuk do të reagonin dhe nuk preknin asnjë banor apo shtëpi pavarësisht bindjeve apo rreshtimit politik dhe luftarak. Në të kundërt hakmarrja do të ishte e rëndë dhe ai nuk mund të bënte asgjë për ti ndihmuar.

Pranvera e vitit 1944 do të sillte jo vetëm rilindjen e jetës pas një dimri të ashpër, por dhe rigjallërimin dhe përforcimin e njësive dhe strukturave të Ushtrisë NÇ. Menjëherë pas kësaj, fillojnë riorganizimin

(Vijon në faqen 9)

PROFIL

TAHIR KOÇI ÇAKËRI, ish partizani me “njollë” në biografi


Në Korçë, Tahir Çakeri është i njohur për kontributin e tij gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, por edhe për presekutimin që provoi familjarisht pas çlirimit.

Demokrati i orëve të para pas '90-tës, Tahir Çakeri është djali i atdhetarit Koçi Tahir Plovishtit, një nga 12 Firmëtarët e Nën Komitetit të fshehtë Krahinor, “Për Lirinë e Shqipërisë”, ose siç quhej në atë kohë në gjuhën popullore, “Besëlidhja Gorare 1906”. Pikërisht për kontributin patriotik, me propozim të shqatës Kombëtare Atdhetare, “Besëlidhja Gorare”, është dekoruar nga Presidenti i Republikës, Z.Bujar Nishani, me Medaljen “Kalorsi i Urdhërit të Skënderbeut”, me Motivacionin: “Në Vlerësim të veprimtarisë e kontributit të vyer atdhetar dhe historik, për Rilindjen Kombëtare dhe fitimin e Pavarësisë së Shqipërisë, si dhe në respekt të kujtimit të pahirushëm të pjestarve të nderuar të saj, të cilët luftuan me pushkë dhe penë në dorë për lirinë dhe pavarësinë e Mëmëdheut”. (Nr i Dekretit 9576. Tiranë më 05 .05. 2016.).

Ndonëse në rethana jo fort të përshtatshme, pasi i jati Koçi Plovishti ishte pushkatuar nga njerzit e Koci Xoxes, Tahiri, del partizan duke u reshtuar në krah të nipit Ferit Çakërit, (djali i vëllait të

tij), i cili kishte qënë në Çetën e Xhezar Senishtit qysh me krijimin e çetës, (Feritin e kishte nip prej motre). Tahiri mer pjesë në disa përpjekje kundër okupatorit Gjerman, i rreshtuar në kompaninë e dytë me Komandant Kompanie, Mehmet Senishtin, e cila ishte pjesë e Batalionit “Skënder Cacit”. Kjo e fundit bënte pjesë në Brigadën e e IX Sulmuse me komandant Taki Kolanecin.

Mbas çlirimit të vendit Tahirin e gjejmë në Organet e Mbrojtjes të Popullit, në Koplík të Shkodrës, i cili qëndron aty deri gati fundi i 1948, ku merr dhe lirinë si bashkëpunor me Koçi Xoxen. Në këtë rast kemi të bëjmë me paradokse nga më të çuditshmet, pasi i jati ishte pushkatuar nga agentët e Koci Xoxes, ndërsa i biri, i Koçi Plovishtit, akuzohej sikur ishte bashkëpunor me Koci Xoxes. Por fal ndërhyrjes të Nasibi Agollit, Kryetarit të Degës të Punve të Brëndëshme të Rethit Shkodër, Tahiri i shpëton burgut, por jo lirinë nga Organet e Mbrojtjes të Popullit. Kështu Tahiri, vjen në shtëpi pranë vëllezërve të tij, por njolla në biografi filloj pak dhe nga pak të bënte punën e vet. Kështu karvani i persekutimeve sa vinte dhe po shtoej. Atë dhe familjen e tij të nderuar i ndoqi gjatë gjithë kohës të ekzistencës të atij sistemi. E sikur kjo



të mos mjaftonte me aq, më vonë Tahiri, sëmuret nga një sëmundje mjaft e rëndë, siç ishte ajo e TBC. Por ashtu siç thotë një fjalë e urtë popullore, “Ditë gjati, nuk bëhet kurë Dit shkurtër”. Vitet kalonin si pa u kuptuar fare, Tahiri, kurrë si preu shpresat. Ai ishte i bindur se një ditë do të ishte ndryshe... Dhe ja kjo ditë erdhi, edhe pse vonoj po erdhi gati gjysëm shekulli më vonë, ku si kudo në vëndet e lindjes dhe këtu tek ne, po trokiste era e Demokracisë.

Tahiri, përfshihet në proceset Demokratike, i cili shoqërohet me drejtusit e PD të asaj kohe duke ngritur degët e saj jo vetëm në krahinën e Gorës dhe më gjërë, ku ai kishte jo vetëm influencën e vet miqësore, por dhe atë shoqërore... Tahiri e dinte fare mire, se ndjenjat atdhetare, ishin ato që njeriun e mbajnë gjallë. Kështu s'mund të ndodhte ndryshe. I jati, Koçi Tahir Plovishti, gjat kohës të Rilindjes tone Kombëtare, u shqua si një atdhetar i devotëshëm, ku këto ndjenjat atdhetare Tahiri, mundi ti trasmetonte tek fëmijët e tij, të cilët u bënë bartës të proceseve Demokratike, ku motoja e tyre ishte atdhedashuria. Sot i biri i tij, Koçi Tahir (Tahiri), Çakëri, është “Pishtar i Demokracisë”, Deputet në Kuvendin e Shqipërisë të legjislaturës që sapo u mbyll.



Tahiri me nje shok partizan (majtas) dhe me ish-partizan

MUHARREM ÇOTA (HOXHË ÇOTA), FIGURË E SHQUAR E TREVËS SË LIBRAZHBIT

(Vijon nga faqja 8)

e batalionit partizan të Bërzeshitës. Reginald Hilbert do të shkruante: “Forcat partizane që gati ishin zhdukur gjatë dimrit tani ishin rritur e organizuar si Sfinks nga hiri”. Në 26 shtator 1944 në Gjinar të Elbasanit do të formohej Br. XVII S, ku Hoxhë Çota u caktua komandant i batalionit të IV, me komisar Niko Dilon.

Brigada kaloi menjëherë në veprime luftarake në zonën e Elbasanit e Peqinit, bëri pastrimin nga trupat pushtuese dhe kolaboracioniste. Në një nga këto përpjekje në Darsi të Peqinit bie në rrethim dhe plagoset. Në këtë betejë humb jetën duke luftuar si hero djali i xhaxhait të tij, Rrahman Çota.

NË ÇLIRIMIN E KRYEQYTETIT HOXHË ÇOTA HUMBI KËMBËN...

Disa javë më vonë Br. XVII S mori detyrë për të marrë pjesë në betejën për çlirimin e Tiranës. Detyra e Br. XVII S ishte që me formacionet e tjera partizane

të pengonte autokollonën gjermane që tërhiqej nga Veriu i Greqisë, për ti ardhur në ndihmë trupave të rrethuara në Tiranë dhe për t'u larguar për në Gjermani. Disa të ashtëquajtur “historian” theksojnë se gjermanët e kishin rrugë kalimi dhe lufta me ta ishte e kotë. Në bazë të dokumentave forcat NÇ kryenin veprime në kordinim të ngushtë me forcat aleate angleze. Është fakt që në betejën e Krrabës morën pjesë dhe avionët anglezë që mbështetën forcat partizane, duke bombarduar forcat gjermane. Këto bombardime për fat të keq shkaktuan dëme dhe te forcat partizane pasi informacioni dhe teknologjia nuk ishin këto që janë sot, por dhe forcat që luftonin me njëra tjetrën ishin shumë afër, sa nga njëherë kishte dhe element të luftimit trup me trup.

Batalioni IV i Br. XVII S me komandant Hoxhë Çotën ishte i vendosur në rrugën Fikas-Mushqeta dhe u bë barrikadë e pakalueshme për forcat gjermane.

Në këtë betejë, me datë 14 nëntor 1944 nga bombardimi i avionëve anglezë Hoxhë Çota plagoset rëndë dhe humbet këmbën. E transportojnë me një

autoblindë në spitalin e Elbasanit ku pas disa ditësh gjëndja e tij rëndohet dhe këmba e plagosur ju gangrenizua. Çlirimi i vendit do ta gjente në gjëndje të rëndë shëndetësore.

Por Hoxhë Çota e fitoi dhe atë betejë dhe më pas do të nisej për kurim më të specializuar në Ljubjana të Sllovenisë. Marrëdhëniet me Jugosllavinë në atë kohë ishin të mira. Atje Hoxha e operoi përsëri këmbën dhe vuri protezë.

Pas kthimit në shtëpi ai ishte shumë aktiv, duke vizituar shokët e bashkëluftëtarët, por dhe duke kontributin në ndërtimin e vendit. Ajo që e bën të veçantë Hoxhë Çotën ishte jeta dhe aktiviteti i tij pas luftës. Ai kurrë nuk bëri kompromis me padrejtësinë dhe me idealet e tij.

Në 15 shkurt të vitit 1973 mbylli sytë në paqe një njeri e luftëtar i jashtëzakonshëm, një patriot e atdhetar, por dhe një burrë i madh e fisnik që gjakun dhe kontributin e shokëve të armëve nuk pranoi ta njollosë për interesa e politika të ulta antihumane. Kështu u largua nga jeta një njeri trim, patriot e fi snik.

HOMAZH

Ish-sekretari i Degës së OBVL Tiranë, pedagogu më i moshuar i Universitetit Politeknik

Prof. HIQMET GONXHJA,

veterani i Inxhinierisë Shqiptare

Prof. Hiqmet Gonxhja, ish-sekretar i Degës së OBVL Tiranë për disa vite, veteran i Inxhinierisë Shqiptare, pedagogu më i moshuar i Universitetit Politeknik të Tiranës dhe përfaqësuesi i shquar i komunitetit dibran në Tiranë, nuk jeton më.

Prof. Hiqmet Gonxhja u nda nga kjo jetë në moshën 94 vjeçare, duke lënë pas një kontribut të madh në fushën e shkencave inxhinierike, publicistike dhe traktateve shkencore. Nga dora e tij janë kryer me qindra studime teknike, të kërkimit dhe zbulimit gjeologjike e gjeofizike, në terrenet më të vështira malore të Shqipërisë. Nga puna e tij si pedagog kanë dalë 110 inxhinierë e teknikë të mesëm topografë, në kurse specializimi pasuniversitare dhe universitare.

Prof. Gonxhja, rrjedh nga familja e arsimtarit të shquar të Dibrës së madhe, Sami Gonxhja, i cili krijoi dhe muzikën e "Marshit të djelmënisë dibrane", të vitit 1921. Prof. Hiqmeti do të mbahet mend si njeri me emocion pozitiv, me humor e shoqëror, dhe si i pari kryetar i shoqatës "Bashkësia Dibrane" pas pluralizimit demokratik në Shqipëri, gjatë viteve 1992-1994, ku pati mjaft aktivitete dhe organizime me komunitetin dibran të Tiranës.

Prof.Asoc.dr. Hiqmet Gonxhja ka lindur në Tiranë me 21 prill 1928 në familjen e arsimtarit demokrat e patriot Sami Gonxhja. Është diplomuar në vitin 1947 si teknik ndërtimi në ish Institutin Teknik "Sadik Stavaleci" të Tiranës (sot Instituti "Harry Fultz"), ndërsa në vitin 1953 diplomohet "Shkëlqyeshëm" në degën e inxhinierisë gjeodezike të Institutit të Lartë të Gjeodezisë, Aerofotogrametrisë dhe Hartografisë në Moskë.

KARRIERA

Inxhinier në zbatim (në terren), gjithsej 10 vjet, nga këto 2 vjet në punimet matëse e rievuere në minierat e para: Rubik, Derven, Krrabë, Bulqizë, Memaliaj, Mborje-Drenovë.

K/inxhinier i Ndërmarrjes Gjeologjike Tiranë – 8 vjet.

Kryetar i ekspeditës topografike – 12 vjet, përkatësisht pranë ish ndërmarrjes Gjeologjike e Gjeofizike të Tiranës, që me 50 grupet e saj inxhiniero-teknike, kryente punime për hartografimin e objekteve dhe zonave, në shkallët 1:500, 1:1000, 1:2000, 1:5000, 1:10 000, për mbështetjen e studim-projektiveve të dokumenteve gjeologjike, kërkimore, zbuluese dhe llogaritje të rezervave të mineraleve të dobishme, kryesisht në terrenet më malore të vendit. Pas daljes në pension (1983), punon pranë Institutit të Studim-Projektiveve Teknologjike Minerare si specialist për projektimin e infrastrukturës rrugore etj., të Fabrikave të Pasurimit (1983/1989). Në periudhën 1993- 2003 (plot 10 vjet) ka punuar inxhinier gjeodet në zbatim



Hiqmet Gonxhe me bashkëshorten e tij të pazëvendësueshme.



Hiqmet Gonxhja tanimë 90 vjeçar, aktualisht gjeodeti më i moshuar në Shqipëri.

për piketimin e pallateve shumëkatësh, të hoteleve dhe si ekspert gjeodet pranë zyrave avokatore dhe Gjykatës së Apelit (Tiranë).

VEPRIMTARIA NË ZBATIM

Ka kryer me metoda të ndryshme (personalisht dhe në grup) punime topogjeodezike për hartografimin në shkallët e lartpërmendura të 35 objekteve dhe zonave të kërkim-zbulimeve gjeologjike, ka ndërtuar bazën gjeodezike për dokumentimin në pozicionin plano-naltrimetrik të situacionit të puseve të naftës (1954-1955) në zonën e Kuçovës dhe të Patosit (S = 150 km²), ka realizuar në bashkëpunim me inxhi.markshejderin Petrit Kollaku takimin e saktë në plan dhe në lartësi të pusit vertikal me traverbankun (tunelin) e Kthellës me gjatësi 1200 metra në minierën e Kurbneshit.

Ka zbatuar për herë të parë në vendin tonë metodat e përparuar për matjen e tërthortë të largësive horizontale me bazislatën "Bala – 2 m" dhe me aparaturën elektro-optike, "EOL – 2000", ma gabi-

min konstant 1 cm për largësinë deri 2 km.

Është nismëtar dhe zbatues i krijimit të planeve dhe hartave topografike në shkallë të ndryshme me metodën stereofotogrametrike tokësore në sektorin e gjeologjisë, ku ka punuar personalisht 8 vjet në terrenet më malore të vendit, përfshi edhe zonën e alpeve (1976-1983).

NË FUSHËN PEDAGOGJIKE

Është aktivizuar si pedagog titullar i jashtëm i Degës (Departamentit) të Gjeodezisë pranë Fak. të Inxh. së Ndërtimit për mbi 25 vjet, përfshi edhe udhëheqjen e dhjetra studentëve diplomantë, përpilimin e shumë reçensave dhe konsultimin e mbi 100 projekt-diplomave për pjesën ekonomike-organizative.

Ka kontribuar si instruktor kryesor, pa shkëputje nga detyrat funksionale, për përgatitjen e rreth 110 teknikëve topografë në 7 kurse speciale 9-mujore (1954-1970) për plotësimin e kërkesave emergjente të Shërbimit Gjeologjik dhe sektorit të naftës.

Z. Gonxhe ka përfaqësuar shërbimin gjeodeziko-hartografik shqiptar në konferencën ndërkombëtare të këtij profili në Budapest (1958) dhe në Drezden (1960).

NË FUSHËN E BOTIMEVE

Ka botuar 2 tekste mësimore universitare (452 faqe), 7 Udhëzues tekniko-metodikë për përdorimin e brendshëm (rreth 200 faqe), 26 artikuj të botuar në revista e gazeta të ndryshme.

Përveç disertacionit prej 75 faqesh, është autor dhe bashkautor i botimit të 3 monografive (me rreth 900 faqe).

- Historiku i organizimit dhe i zhvillimit të punimeve topogjeodezike gjatë periudhës 40 vjeçare në sektorin e Gjeologji-Gjeofizikës (1955-1995).

- Portreti gjeodeziko-hartografik i Shqipërisë (b/ autor dhe redaktor kryesor).

- Ndihmesa e shquar e ish nxënësve të Shkollës Teknikë dhe mësuesve të tyre për zhvillimin e vendit në luftën për çlirim dhe demokraci.

Gjithashtu është b/autor i librit të normave unike të prodhimit në punimet topogjeodezike në shkallë republikane, i miratuar me vendim të posaçëm të qeverisë moniste në vitin 1960 (100 faqe) dhe b/ autor i Manualit për teknik gjeologë (350 faqe). Tre vitet e fundit ka shkruar 2 monografi me rreth 700 faqe, ku njëra prej të cilave mban titullin: "Njohuri thelbësore mbi gjeologjinë, hartografi – gjeodezinë dhe matematikë - gjeometrinë e aplikuar", i paracaktuar për lexuesit jo specialistë dhe veçanërisht për mësuesit e matematikë-gjeometrisë.

Kjo monografi është e para e këtij lloji, veçanërisht në literaturën gjeologjike dhe në atë të matematikë-gjeometrisë.

Risia e kapitullit të matematikës qëndron në njohuritë konkrete që jepen për llogaritjen dhe zgjidhjen e ushtrimeve më tipike analitike, jo në sistemin koordinativ gjeodezik, por në sistemin kartezian.

Kjo monografi është botuar nga Botimet M&B, 2019, 303 faqe.

Në arshivën teknike të Qendrës Gjeofizike të SH.Gj.Sh. janë depozituar mbi 30 relacione e raporte teknike të z. Hiqmet Gonxhe si autor dhe b/ autor, që po ti shtohen edhe llogaritjet gjeodezike voluminoze të dokumentuar, bashkëshoqëruese, ato do të zinin qindra faqe.

Rreth 1600 plane dhe harta topografike të shkallëve të ndryshme që i përkasin fondit të hartografimit të qindra objekteve dhe zonave të kërkim-zbulimeve gjeologjike, mbajnë nënshkrimin garantues të z.Gonxhe, në cilësinë e udhëheqësit teknik të Shërbimit Topografik të sektorit gjeologjik gjatë një periudhe 20 vjeçare.

Për meritat dhe përkushtimin në detyrat e ngarkuara, është dekoruar me 5 medalje, (2 nga të cilat si veteran i Luftës Antifashiste) dhe 2 Urdhra Pune.


LIBRI

Një vepër letrare që ju bën nder atyre që vuajtën mizoritë komuniste

“KLITHMA NGA BURGU”

i Shpendi Topollajt, homazhi më njerëzor

- *Janë të rrallë ata shkrimtarë që si ky autor, në të gjithë krijimtarinë e tyre t'i kenë kushtuar kaq vëmendje këtyre njerëzve të nderuar dhe fisnikë që bënë sakrificat të panumërta vetëm pse nuk u pajtuan asnjëherë me komunizmin. Respekti për ta ndihet i pranishëm në poezitë, tregimet, novelat, romanet, dramet, publicistikat dhe në dhjetra librat me kritika letrare që ky autor ka botuar*



ishaj, Gjergj Komnino, Veronika Dafa, Vaso Papaj, Bahri Hoxha, Halim Ramohito, Gëzim Medolli, Uran Butka, etj. janë vetëm disa nga ata, sikurse ai u ka kushtuar gjithë artin e tij qëndrimin trimëror prej njerëzish me karakter të pathyer të Adem Allçit, Hafiz Sabri Koçit, Thoma e Stavri Rafaelit, Trifon Xhagjikës, Fadil Kokomanit, Vangjel Lezhos, Rukie Ramës, Rahman Parlakut, Petrit Dumes, Abaz Fejzos, Isuf Allamanit, dr. Ludovik Kalmarit, Luigj Benussit, Zoi Xoxes etj. Intelktual demokrat, pa nxitur aspak urrejtje, veç mirëkuptim e falje, sikurse e tregon edhe romani i botuar tash së fundi “Pajtimi”, Shpendi mbetet njëri nga shkrimtarët tanë që ka dhënë një kontribut të çmuar në demaskimin e krimeve të komunizmit në Shqipëri. Njeri i dashur për këdo, pavarësisht krahut që ata përfaqësojnë, Shpendi e konsideron domosdoshmëri vlerësimin e të përndjekurve politikë dhe dhënien atyre të gjithçkaje u detyrohet ligërisht shoqëria jonë.

Po mbi të gjitha, ai shpreh bindjen se ata duhet të zenë vendin që u takon në shoqëri, pas atyre që kaluan burgjeve e internimeve, ku u shkoi mes përbuzjes rinia, deri dhe fëmijëve të tyre. Është kjo arsyeja që ai, në një shënim në faqen e pasme të kopertinës shkruan: “U përkulem me respektin më të madh, të gjithë ju motrave dhe vëllezërve që vuajtën pa asnjë faj, tmerret e burgjeve komuniste; por ta dini se Atdheu u ka nga bijat dhe bijtë më të mirë dhe populli do t'u jetë përherë mirënjohës për gjithë sa bëtë që liria dhe demokracia të lulëzojnë edhe te ne si në të gjitha vendet e qytetëruara”. Realisht, nuk tingëllon aq mirë kur sheh se edhe pas tridhjetë vitesh demokraci ka ende probleme në trajtimin e tyre. Por për këtë autor, nuk është vetëm kjo; ai në të gjitha shkrimet e tij, duhet se shqetësohet për atë që njerëzit duket se janë të prirur të harrojnë, dhe kjo do të qe fatkeqësi e madhe. Nga ana tjetër, ai merakoset edhe

për faktin se brezi që nuk e jetoi atë diktaturë të pashembullt, nuk e di se ç'ka ngjarë, sikurse edhe nuk i besohet se shteti mund t'ua nxinte jetën deri në atë shkallë, qytetarëve të tij. Ka botuar vite më parë Sh. Topollaj librin me epigrame “Ishte koha kur...”, një libër që do të ishte i domosdoshëm të gjente përhapje të gjerë, deri edhe në shkollat tona. Fundja, pikërisht këtë synim ka pasur edhe libri i nobelistit rus Aleksandër Sollzhenjicin, të cilit ai i referohet herë pas here. I referohet, pasi në krimet e tyre, diktaturat ngajajnë. Ca më shumë ajo jona me atë të Josif Stalinit, të cilin Enver Hoxha e quante babanë e tij shpirtëror dhe me të cilin i lidhte ideologjia e përbashkët. Duke ditur sesa i nevojshëm është demaskimi i asaj ideologjie që jo vetëm solli aq mjerime, por edhe e ndau dhe përçau mizorisht popullin tonë, Shpendi ka analizuar me kompetencë, fakte, thellësi argumenti dhe kurajë të admirueshme librat demagogjikë të Nexhmije Hoxhës, Liljana Hoxhës, Kiço Mustaqit, Rrapi Minos, Feliks Tuçevit (Felix Tchouev: “Biseda me Molotovin”), çiftit francez Elisabeth dhe Jean - Paul Champseix etj. Në këtë këndvështrim, pa asnjë ndikim politik, pa asnjë interes a përfitim, pasi veç të tjerash, ai që prej dhjetë vjetësh është në pension dhe po e kalon gjithë jetën në një sipërfaqe prej 50 m2, juristi Shpendi Topollaj, me ndershmërinë e tij, guximin për fjalën e lirë dhe bindjet e pastra për demokracinë, është jo vetëm një njeri i dashur dhe i besueshëm për këdo, por ndofta edhe shembulli që duhet të frymëzojë çdo intelektual të këtij vendi në gjithë krijimtarinë apo qëndrimin e tij. Ja, pse ai ka gjithë të drejtën me vete që të konsiderohet si njëri nga apologjetët më besnikë dhe të paluhatur të të gjithë asaj shtrese që duke qenë aq largpamëse, i pagoi shtrenjtë idealet për të cilat luftoi. Është e vërtetë se ai, bir i njerit nga luftëtarët më të vjetër të Kolonjës dhe një nëne nga familja

atdhetare e Agallinjve të Vlorës, që u përndoqën egërsisht nga komunizmi, duke qenë oficer u ndëshkua pa asnjë faj, u la në detyra nga më të ultat, larg gruas e vajzave të tij, iu kontrollua shtëpia, u survejua nga sigurimi famëkeq dhe nuk ju nda “Dosja 2A”. Por, në asnjë rresht të krijimtarisë së tij nuk nxitet përçarja dhe hakmarrja. Ai, herë pas here bën thirrje për mirëkuptim, bashkim dhe vëllazërim. Dhe e gjithë kjo, është e qartë si drita e diellit edhe në artikujt e pareshtur që ai boton në shtypin e ditës. Ja si shprehet ai në njërin prej tyre: “Atdheun të gjithë e duam njëlloj. Nuk duhet harruar se qysh atëherë, në botë, por edhe në Shqipëri ka rrjedhur shumë ujë; koha e gjatë që ka kaluar (se nuk janë pak afro tetëdhjetë vjet), ka qenë mëse e majftueshme, si për të krijuar sekush bindjen e tij, ashtu edhe për të fashitur mospajtimin. Sot ne jemi miqësuar dhe kërkojmë të na pranojnë në aleanca shtete dhe pinjollët e atyre që na sulmuasn me avionë, tanke e topa, që na vranë, na dogjën e na plaçkitën, dhe nga ana tjetër, i bëjmë karshillëk vëllezërve të të njëjtit gjak. A nuk tingëllon si paradoksale kjo? Si do na dukej sikur në Francë fjala vjen, ende të vazhdonin konfliktet dhe stigmatat midis zhirondinëve të moderuar dhe jakobinëve të Robespierit, paçka se këta e kishin përfunduar misionin qysh në fund të korrikut të vitit 1794? Për njerëzit e mençur, nuk mund të vazhdohet në përfundësi kështu. Evropa i ka kapërcyer me kohë ndarjet e tilla. Mjaft me armiq imagjinarë. T'i shtrijmë dorën e miqësisë njëri - tjetrit”.

Për të qënë deri në fund të vërtetë, duhet pohuar se domosdoshmëria e këtij bashkimi ka qënë kredua e të gjithë atyre personazheve për të cilët flet Shpendi. Dhe Shpendi i portretizon ata si mendimtarë, si intelektualë me formim perëndimor, për të mos thënë se disa prej tyre si Arshiu, Kalakulla, Lubonja, Hafizi, Dhora, Titani, Visari, Komnina, Zoi, Butka, kishin format filozofik. Kundërshtimi i tyre me sistemin ishte ai i ndeshjes së ideve dhe mendimeve. Në atë luftë ata nuk ishin në kushte të barabarta, ndaj sakrifkuan aq shumë, pasi ideve të tyre ju kundërvu pushka. Por ja që vjen një ditë dhe ata futen me lavdi në altarin e Kombit, ndërsa xhelatët e tyre mbërthehen në shtyllën e turp. Dhe duke pasur parasysh se aspiratë e të dënuarve politikë ka qënë edhe bashkimi i Kosovës me Shqipërinë, kushtimi i këtij libri Heroit Ramush Haradinaj, është një gjetje mjaft domethënëse, ashtu sikurse është kuptimplotë edhe gatishmëria e Institutit të të Përndjekurve Politikë me në krye zotin Bilal Kola për ta botuar këtë libër me kaq vlera, libër i cili duket si një pedestal për monumentet e atyre që bënë aq shumë për atdheun e tyre.

FATMIR MINGULI

Libri me gati 500 faqe “Klithma nga burgu” i autorit Shpendi Topollaj, botim i 2MPrinting, i shkruar nga një mjeshtër i shquar i fjalës dhe mjaft i kulturuar, është ndofta homazhi më njerëzor, më i sinqertë dhe më dashamirës që u është kushtuar vuajtjeve, rezistencës, dinitetit, guximit, mençurisë dhe idealeve të pastra të të gjithë atyre që provuan llahtarit e krimeve komuniste. Janë të rrallë ata shkrimtarë që si ky autor, në të gjithë krijimtarinë e tyre t'i kenë kushtuar kaq vëmendje këtyre njerëzve të nderuar dhe fisnikë që bënë sakrificat të panumërta vetëm pse nuk u pajtuan asnjëherë me komunizmin. Respekti për ta ndihet i pranishëm në poezitë, tregimet, novelat, romanet, dramet, publicistikat dhe në dhjetra librat me kritika letrare që ky autor ka botuar. Dhe jo vetëm kaq; Shpendi Topollaj, duke qenë pranë tyre, dhe mik me ta, qysh nga përmbyjsja e sistemit të kaluar, ka qenë një organizator i pasqor në promovimin e veprës së tyre. Librave që ata kanë shkruar rreth asaj që pësuan (kujtime apo monografi), apo dëmeve që iu bënë atdheut nga sundimi i barbarëve të kuq megallomanë, ai u ka bërë jehonë në takime mbresëlënëse në Pallatin e Kulturës “A. Moisiu dhe qytete të tjera, ka botuar pa fund artikuj kushtuar veprës së atyre dhe i ka zgjedhur dhe skalitur pikërisht ata si personazhe të respektuara të gjithë prozës së tij aq të pëlqyer. Arshi Pipa, Dhora Leka, Uran Kalakulla, Hysen Haxhia, Gjergj Titani, Visar Zhiti, Agim Musta, Fatos Lubonja, Saimir Maloku, Enver Mem-

DITËLINDJA

PROF. XHEMAL MEÇI

FESTON 85-VJETORIN E LINDJES

Profesor Xhemal Meçi - Mjeshtër i "Madh", më 23 korrik festoi 85 - vjetorin e ditëlindjes në një atmosferë mjaftë festive, në gjirin e familjes së tij të mrekullueshme, të afërmëve e miqve të tij të shumtë, jo vetëm pukjanë, por edhe nga Tirana, Shkodra e Kosova.

Nderuan kështu ata këtë dishepull të dijes, i cili në më shumë se shtatë dekada pune të mirëfilltë studimore e kërkimore-shkencore i ka dhuruar publikut vepra monumentale, siç mund të konsiderohen botimet e tij: "Puka që në Lashtësi"; "Poeti i Malësisë"; "Poeti i Kabashit"; "Kanuni i Lekë Dukagjinit, varianti i Pukës"; "Kanuni i Lekë Dukagjinit, varianti i Mirditës"; "Kabashi"; "Migjeni në Pukë: me bashkëautor"; "Komani, Ana e Drinit-Delmace trashigimi iliro-arbnore", etj. Është pikërisht kjo veprë e mirëfilltë në fondin e letërsisë sonë dokumentare, që e bën Prof. Xhemalin një autor me kontribut të veçantë në fushën e historiografisë.

Vepra e tij është vlerësuar nga personalitete të shkencës e të letrave të cilët ia kanë përcjellë atë lexuesit me recensa mjaftë pozitive. Në këtë jubile të 85 - vjetorit të ditëlindjes ai premtoi se do të botojë së shpejti vepra të tjera, si: "Puka në luftë për liri e dëshmorët e saj"; "Qyteti i Pukës dhe lagjet Fshat"; "Migjeni përsëri në Pukë"; "Doke lidhur me blegtorinë dhe bujqësinë në Pukë"; "Malësia e Gjakovës (Tropoja) në vështrimin etnografik"; "Lura në veçoritë e hershme të saj etnokulturore" etj.

Studiuesi Xhemal Meçi, me një aktivitet 85 vite jetësore dhe mbi 65 vite eksperiencë pune ka spikatur në sektorë të ndryshëm si, arsimtar, zëvendës/drejtor e drejtor shkollash e të kabinetit pedagogjik Pukë, sekretar i gjykatës Pukë, Përgjegjës i muzeut historik Pukë dhe me një veprimtari të dendur studimore shkencore si dhe drejtues i shoqatës së historianëve të Pukës. Ai është mbajtës i mbi 65 kumtesave e referateve në sesione shkencore, simpoziume, konferenca e kongrese lokale , kombëtare e ndërkombëtare. Ka përgatitur e botuar mbi 100 artikuj me karakter shkencor në gazeta e revista. Puna, vepra dhe veprimtaria e tij studimore është vlerësuar me dëshmi e certifica të shumta. Për më shumë se 45 vjet ka qenë bashkëpunëtor i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë (Instituti Kulturës popullore, Instituti i Gjuhës e Letërsisë, Instituti i Historisë), si dhe bashkëpunëtor i Universitetit "Luigj Gurakuqi" Shkodër (sektori i Albanologjisë) por edhe bashkëpunëtor i Institutit të Albanologjisë në Prishtinë, Kosovë.

Ndaj dhe pjesëmarrësit në këtë ceremoni festive të ditëlindjes së tij të 85-të, dhe jo vetëm ata, por miqtë e tij të shumtë në Shqipëri e në hapësirën mbarëshqiptare në botë, i uruan jetëgjatësi e shëndet të plotë, si dhe krijimtari sa më produktive e cilësore.

Ceremonia festive e ditëlindjes së tij të 85-të u organizua nga Shoqata "Sofra pukjane".

Halil RAMA

